

Gjykata Themelore e Prishtinës
PKR. nr. 237/13
Prishtinë, 29 nëntor 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

Në emër të popullit

Gjykata Themelore e Prishtinës, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it, Vladimir Mikula, si kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët vendorë Florent Latifaj dhe Aferdita Bytyqi, si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga proces-mbajtësja Vlora Johnston dhe përkthyesja Anila Shehu, në lëndën penale kundër:

Y.J.

I akuzuar me pesë (5) vepra penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të lëndëve narkotike dhe lëndëve psikotropike të rrezikshme, në shkelje të nenit 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së;

një (1) veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328, paragrafi 2 të KPK-së, dhe,

veprën penale të krimit të organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së,

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik dhe pas dëgjimit të deklaratave përfundimtare të Prokurorit të PSRK-së, Andrew Carney, të mbrojtësve Z.J. dhe R.G., dhe të pandehurit Y.J., më 27 nëntor 2013

Pas seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur më 27 nëntor 2013, në bazë të neneve 359, 361, 365 dhe 366, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), trupi gjykues më 29 nëntor 2013, shpall në publik këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri Y.J., më parë V., Kosovë, shqiptar i Kosovës,

Është fajtor

Sepse

- Nga data 27 gusht 2010 deri në datën 12 tetor 2010, në territorin e Kosovës udhëzoi, kontrolloi dhe komunikoi me telefon me grupin e njerëzve të përbërë nga M.G., F.Z., S.A.dhe J.B. rreth blerjes, shitjes, transportimit, lëvrimit, eksportimit nga Kosova dhe importimit në Republikën Federale të Gjermanisë, përmes vendeve të tjera në Europë, të një dërgese me 4.56 kg (pesha neto) heroinë, lëndë narkotike që ishte futur brenda 9 paketave të sekuestruara në gomën e përparme të një automjet tip Benzi Mercedes klasa C, me tabela sllovene XX në Muni, Gjermani, më 11 tetor 2010, dhe çdo person në këtë grup kishte role të posaçme në lidhje me këtë transaksion.
- Nga data 13 gusht deri në datën 14 shtator 2010, Y.J. në territorin e Kosovës udhëzoi, kontrolloi dhe komunikoi me telefon me grupin e njerëzve të përbërë nga S.F., M.D. and F.Z., rreth blerjes, shitjes, transportimit, lëvrimit, eksportimit nga Kosova dhe importimit në Republikën Federale të Gjermanisë, përmes vendeve të tjera në Europë, të një dërgese heroine me peshë 418 gramë, që u sekuestrua në banesën e M.D.-ut në Muni, Gjermani më 14 shtator 2010, dhe çdo person në këtë grup kishte role të posaçme në lidhje me këtë transaksion.
- Nga data 2 janar 2011 deri në datën 12 janar 2011, Y.J., në territorin e Kosovës, udhëzoi, kontrolloi dhe komunikoi me telefon me grupin e njerëzve të përbërë nga M.O. dhe A.M. rreth blerjes, shitjes, transportimit, lëvrimit, eksportimit nga Kosova dhe importimit në Republikën Federale të Gjermanisë, përmes vendeve të tjera në Europë, të një dërgese me 1.992 kg (pesha neto) heroinë, dhe që u sekuestrua nga një automjet tip Benz Mercedes, me tablla të regjistrimit XX në Muni, Gjermani, më 11 janar 2011, ku heroina ishte e mbështjellë brenda 4 pakove, ku secila peshonte afërsisht 0.497 kg.
- Më 2 tetor 2012, Y.J. në territorin e Kosovës, në Rrugën XX , Prishtinë, posedoi pa autorizim dhe me qëllimin për të shitur, një përzierje heroinë dhe paracetamol me peshë 11.66 gramë, të futur brenda një qeseje plastike, të sekuestruar nga policia nga prapa tualetit të banjës në banesën e Y. J.në Kosovë më 2 tetor 2012.
- Më 2 tetor 2012, Y.J., në territorin e Kosovës, në katin përdhes të shtëpisë së okupuar nga Y.J. në XX, XX, Kosovë, posedoi pa autorizim dhe me qëllimin për të shitur, 3.38 gramë cannabis sativa, lëndë narkotike që u sekuestrua nga policia më 2 tetor 2012.

Prandaj,

Ad1)

I pandehuri Y.J. pa autorizim bleu, posedoi me qëllimin për të shitur, shpërndarë, ofruar për shitje, lëndë që janë shpallur droga narkotike të rrezikshme.

Me çka,

I pandehuri Y.J. kreu veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes pa autorizim të drogave narkotike dhe lëndëve psikotropike të rrezikshme, në shkelje të nenit 229, paragrafët 1, 2, 3, të Kodit Penal të Kosovës (Kodi i vjetër Penal i vlefshëm deri më 31/12/2012),

Në bazë të neneve 34, 38, 64, 73 dhe 229, paragrafi 3, të Kodit Penal të Kosovës, të vlefshëm deri më 31 dhjetor 2012, **dënohet** me 6 (gjashtë) vite burgim.

Në bazë të nenit 54, paragrafët 1, 2, nën-paragrafi 7, nenit 60 dhe nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Penal të Kosovës (i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2012), të 11.66 gramët e përzierjes së heroinës me paracetamolit dhe të 3.38 gramët e cannabis sativa, të dyja të sekuestruara më 2 tetor 2012, **konfiskohen**.

Dhe,

Ad2)

Prandaj,

I pandehuri Y.J. mbikëqyri dhe menaxhoi veprimtaritë e një grupi të organizuar kriminal,

Me çka, ai kreu veprën penale të krimit të organizuar, në bazë të nenit 274, paragrafi 3, të Kodit Penal të Kosovës (i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2012).

Në bazë të neneve 34, 38, 39, 64, 73 dhe 229, paragrafi 3, të Kodit Penal të Kosovës, të vlefshëm deri më 31 dhjetor 2012, **dënohet** me 8 (tetë) vite burgim dhe gjobë në shumën e 25 000 eurove, që duhet të paguhet brenda një muaji nga data kur ky Aktgjykim do të bëhet përfundimtar.

Në rast se i pandehuri Y.J. nuk do të dëshirojë ta paguajë gjobën dhe nuk do ta pranojë zëvendësimin e gjobës me urdhër për punë në shërbim të komunitetit, gjoba do të zëvendësohet me një ditë burgim për çdo 15 euro. Megjithatë, afati i burgimit nuk do ta kalojë periudhën e gjashtë muajve.

Në bazë të nenit 71 të KPK-së, Gjykata vendos dënimin unik në afat 11 vite burgim dhe gjobë në shumën 25 000 euro, që duhet paguar brenda një muaji nga data kur ky Aktgjykim do të marrë formë të prerë.

Në rast se i pandehuri Y.J. nuk do të dëshirojë ta paguajë gjobën dhe nuk do ta pranojë zëvendësimin e gjobës me urdhër për punë në shërbim të komunitetit, gjoba do të zëvendësohet

me një ditë burgim për çdo 15 euro. Megjithatë, afati i burgimit nuk do ta kalojë periudhën e gjashtë muajve.

Në bazë të nenit 54, paragrafët 1, 2, nën-paragrafi 7, nenit 60 dhe nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Penal të Kosovës (i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2012), të 11.66 gramët e përzierjes së heroinës me paracetamol dhe të 3.38 gramët e cannabis sativa, të sekuestruara të dyja më 2 tetor 2012, **konfiskohen.**

Po kështu,

Akuza me përshkrimin e mëposhtëm kundër të pandehurit Y.J. (më parë V.), me shënimet personale të përmendura më lart,

Në bazë të nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, të KPP-së, **hidhet poshtë.**

AKUZA 5

Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar e armëve, në shkelje të nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së, dhe veprë e dënueshme me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim nga një deri në tetë vite.

Sepse

Më 2 tetor 2012, Y.J., në territorin e Kosovës, kreu veprën e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, pasi ai kishte në pronësi, kontroll ose posedonte tre armë, konkretisht, një pushkë gjuetie me veprim me pompë, të tipit Kratay Magnum, me numër serik XX, plus municionin, një pistoletë me gaz të tipit Ekol Tuna, me numër serik XX, plus municionin, dhe një pistoletë me gaz të tipit Ekol Special-99, me numër serik XX, plus municionin.

Sepse ky akt është mbuluar nga Ligji për Amnistinë, Nr. 04/L-209.

Paraburgimi në lidhje me Y.J. vazhdohet deri sa Aktgjykimi të bëhet përfundimtar, sepse rreziku i arratisjes ende ekziston, siç parashikohet nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.2.1 të KPPK-së, por jo më gjatë se afati i burgimit të vendosur në këtë Aktgjykim. Koha e kaluar nga Y.J. në paraburgim që nga data 02.10.2012 e këtij do t'i llogaritet në dënimin e burgimit, në bazë të nenit 365 paragrafi 1.5.

I pandehuri është i detyruar të paguajë shpenzimet e procedurës penale si vijon:

Shuma 2.500 euro për Ekspertizën e Zërit, shuma 449 euro për Panelin e Ekspertëve dhe shuma paushall prej 1.000 eurosh, në bazë të nenit 365 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6 të KPPK-së.

ARSYETIM

I. Ecuria procedurale

Aktakuza

Më 11.04.2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) paraqiti Aktakuzën PPS nr. 42/2012, datë 09.04.2013, kundër të pandehurit Y.J., me të cilën i vinte në barrë pesë (5) vepra penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të drogave narkotike dhe lëndëve psikotropike të rrezikshme, në shkelje të nenit 229, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së; një (1) vepër penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328, paragrafi 2 të KPK-së, dhe veprën penale krimin të organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3, të KPK-së.

Më 23 maj 2013, u mbajt shqyrtimi i parë fillestar, në pajtim me nenet 245 dhe 246 të KPPK-së. I pandehuri nuk u vetë-deklarua fajtor për ndonjë nga akuzat e Aktakuzës. Shqyrtimi i dytë u mbajt më 26 qershor 2013, ku kryetari i trupit gjykues caktoi shqyrtimin kryesor, pasi që nuk pati kundërshtime, sipas nenit 249 dhe nenit 250 të KPPK-së. Asnjëra prej palëve nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues.

Në deklaratën përmbyllëse të tij¹ Prokurori i PSRK-së i kërkoi Gjykatës ta gjente të pandehurin Y.J. fajtor për të gjitha veprat e lidhura me drogën dhe krimin e organizuar, dhe propozoi që ai të dënohet në bazë të ligjit, sepse ishte provuar se i pandehuri u përfshi në kryerjen e veprave penale me të cilat akuzohej. Në lidhje me këtë, prokurori i lëndës parashtrroi që, gjatë periudhës përkatëse, maj 2010 deri në janar 2011, i pandehuri Y.J. ishte organizatori i furnizimit të 22.5 kg pluhur me përmbajtje heroine tek të gjithë ata individë të tjerë të emërtuar si bashkë-kryerës. U tha gjithashtu se i pandehuri Y.J., si furnizues, ishte më lart zinxhirit të komandës se të gjithë të tjerët. U theksua se nga i pandehuri Y.J. u përdorën dy numra telefoni (+386 (0) XX dhe +386 (0) XX), për të organizuar furnizimin e drogave, dhe se kjo u konfirmua me bisedat e përgjuara dhe tekst-mesazhet, sepse ato kishin të bënin të gjitha me lëndë narkotike. Se nga përgjimi i bisedave, M.G. dhe të dy korrierët, S.A. dhe J.B., të cilët vozisnin një veturë Mercedes, më 11 tetor 2010 u arrestuan në posedim të nëntë pakove me pluhur heroine me peshë 4.56 kg, dhe se më 11 janar 2011, M.O., A.M. dhe F.Z. u arrestuan pasi iu zbuluan 1.9 kg heroinë në një automjet të dytë. Se ekspertiza e zërit² provoi se ishte i pandehuri ai që po fliste në linjat e përgjuara, që u krahasuan me kampionin e zërit të marrë nga i pandehuri Y.J.³. Më tej, prokurori

¹ Bashkëngjitur Proces-verbalit të Shqyrtimit Gjyqësor të datës 27 nëntor 2013, faqet 2-5

² Ekspertiza e Zërit u krye nga Profesor L. R. në bazë të Vendimit të Gjykatës të datës 26 korrik 2013.

³ Kampionët e zërit u morën më 6 gusht 2013, në prani të kryetarit të trupit gjykues, prokurorit të lëndës dhe Mbrojtësve të të pandehurit.

i lëndës parashtroi se Paneli i Ekspertëve⁴ konfirmoi se i pandehuri Y.J. ishte njeri inteligjent dhe jo një person i shkatërruar nga droga, me inteligjencë të ulët, që u përpoq të pretendonte se ishte, kur doli para gjykatës.

Lidhur me veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së, prokurori e tërhoqi këtë akuzë, sepse ky akt u përfshi në Ligjin për Amnistinë, Ligji nr. 04/L-209.

Në deklaratën përmbyllëse të tij, Mbrojtësi Z.J. parashtroi se Aktakuza nuk mbështetej në prova të vlefshme. Referencë iu bë telekomunikimeve të përgjuara, duke mohuar se ishte i pandehuri Y.J. ai që po fliste në ato linja. Më tej u deklarua se as Ekspertiza e Zërit nuk e provoi këtë, sepse gjetjet e saj ishin në nivelin e mundësisë ose përakisë. Mbrojtësi Z.J. vuri në piëpyetje metodat e përdorura nga Profesor R. sepse asnjëra prej metodave nuk u konfirmuan ndonjëherë nga ndonjë institucion përkatës në botë. Referencë u bë edhe lidhur me gjetjet e Panelit të Ekspertëve në lidhje me gjendjen mendorë të të pandehurit. Lidhur me këtë, Mbrojtësi Z.J. tha se nuk kishte pretenduar se klienti i tij është person i papërgjegjshëm, Megjithatë, ai theksoi se truri i të pandehurit është cenuar përgjithmonë sepse ai kishte abuzuar me lëndët narkotike nga mosha 13 (trembëdhjetë) vjeç, dhe asnjë ekspert nuk mund ta bindë atë se përdorimi afatgjatë i lëndëve narkotike nuk lë ndonjë dëmim në trurit e njeriut. U parashtua gjithashtu se pretendimi i prokurorit se i pandehuri ishte udhëheqës i grupit nuk qëndron sepse personat e varur nga droga nuk mund të jenë udhëheqës të ndonjë grupi, aë më pak klienti i tij. Mbrojtësi Z.J. e përfundoi deklaratën e tij me fjalët se Aktakuza nuk u provua, prandaj ai i kërkoi Gjykatës ta lirojë nga akuza klientin e tij.

Në deklaratën përmbyllëse të tij, Mbrojtësi R.G. ngriti çështjen e pranueshmërisë së provave. Sipas Mbrojtësit R.G., provat nuk ishin siguruar në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Mbrojtja e konsideroi me rëndësi se duhen dëgjuar edhe të pandehurit e tjerë, të cilët ishin gjykuar në gjermani. Ai gjithashtu u deklarua se prokurori nuk arriti të provojë se banesa/t ku jetonte Y.J., si dhe pasuria e konfiskuar, i përkisnin të pandehurit dhe se ato prona u blenë me paratë e siguruar nga veprimtaritë e paligjshme të të pandehurit. Mbrojtësi R.G. e përfundoi deklaratën e tij duke i kërkuar Gjykatës të kthejë sendet e konfiskuara dhe ta lirojë të pandehurin Y.J. nga akuza.

I pandehuri Y.J. nuk u vetë-deklarua fajtor dhe mbështeti deklaratat e Mbrojtësve të tij.

⁴ Paneli i Ekspertëve u emërua në bazë të Vendimit të Gjykatës 26 shtator 2013, që përbëhej nga Prof. Dr. Z.H., Neuropsikiatre, Dr. N.I.M., Psikiatre dhe Psikologe e EULEX-it, Mgr. H.K. Ph.D.

II. Provat

Në seancat e shqyrtimit kryesor u administruan dhe vlerësuan këto prova të propozuara nga Prokurori i PSRK-së dhe Mbrojtësit:

- Përgjimi i telekomunikimeve;
- Deklaratat e këtyre dëshmitarëve:
- A.K.S., Oficer i Policisë së EULEX-it, Njësia e Hetimit të Krimin të Organizuar, i cili dha përgjigje të hollësishme në lidhje me kontrollin e shtëpisë dhe Raportet që rezultuan nga kontrollet
- A.O. , Oficer i Policisë së Kosovës, hetues, Njësia e Hetimit Financiar
- M.L., i cili dha gjithashtu shpjegim në lidhje me kontrollet e shtëpive dhe raportin që rezultoi nga kontrollet, dhe
- TH.A., Kryekomisar Penal, Forca Policore, Munihi
- Raporti i Ekspertizës së Zërit
- Raporti i Panelit të Ekspertëve në lidhje me gjendjen mendore të të pandehurit Y.J.

Lista e **komunikimeve të përgjuara** – sipas Radhës së paraqitur nga Prokurori i PSRK-së u dëgjua në seancën e 16 korrikut 2014:

Y. V./J., M.G., F.Z. (pseudonimi 'B.), S.A.dhe J.B., maj – tetor 2010

- (1) 14.08.2010 në orën 18:05:57 Y. V. +386 (0)XX thirri M.G. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.488.368 (Dosja IX, f. 28-33).
- (2) 16.08.2010 në orën 18:32:18 Y. V. +386 (0) XX thirri M.G. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.489.840 (Dosja IX, f. 43-46).
- (3) 16.08.2010 në orën 18:35:56 dhe 19:04:24 Y. V. +386 (0) XX thirri një mashkull të panjohur i cili besohet të jetë korrieri +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.489.843 dhe, letërnjoftimi 1.489.954 (Dosja IX, f. 47-51).
- (4) 16.08.2010 në orën 19:16:37 Y. V. +386 (0)XX thirri M.G. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.489.966 (Dosja IX, f. 52-54).
- (5) 16.08.2010 në orën 19:44:50 mashkull i panjohur korrier/M.G. +381 (0) XX thirri Y. V.n +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.490.011 (Dosja IX, f. 67-71).
- (6) 16.08.2010 në orën 19:56:08 M.G. +381 (0) XX thirri Y. V.n +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.490.034 (Dosja IX, f. 75-77).

- (7) 19.08.2010 në orën 12:54:03 B.K. +386 (0) XX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.492.873 (Dosja IX, f. 90-96).
- (8) 22.08.2010 në orën 19:47:02 M.G. +381 (0) XX thirri Y. V.n +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.494.686 (Dosja IX, f. 129-131).
- (9) 27.08.2010 në orën 10:47:55 Y. V. +386 (0) XX thirri M.G. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.508.903 (Dosja IX, f. 187-188).
- (10) 27.08.2010 në orën 12:08:58 M.G. +381 (0) XX thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.508.987 (Dosja IX, f. 189-191).
- (11) 27.08.2010 në orën 20:31:28 F.Z. (B.) +49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh B.K. +386 (0)49317886, letërnjoftimi 1.509.616 (Dosja IX, f. 196-197).
- (12) 06.09.2010 në orën 17:23:03 +386 (0) XX Y. V. thirri M.G. +381 (0)XX, letërnjoftimi 1.647.114 (Dosja IX, f. 421-424).
- (13) 11.09.2010 në orën 10:35:44 M.G. +381 (0) XX thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.650.798 (Dosja IX, f. 443-446).
- (14) 11.09.2010 në orën 10:38:14 Y. V. +386 (0)XX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.650.801 (Dosja IX, f. 447-449).
- (15) 11.09.2010 në orën 10:39:05 +381 (0) XX G. thirri Y.V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.650.804 (Dosja IX, f. 450-452).
- (16) 11.09.2010 në orën 10:39:49 M.G. +381 (0) 66-5094977 thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.650.805 (Dosja IX, f. 453-455).
- (17) 11.09.2010 në orën 12:24:03 M.G. +381 (0) 66-5094977 thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.650.858 (Dosja IX, f. 456-458).
- (18) 12.09.2010 në orën 20:16:30 +49 (0) XX SMS nga F.Z. për një tjetër +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.651.931 (Dosja IX, f. 459-460).
- (19) 14.09.2010 në orën 19:05:01 Y. V. +386 (0)XXX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.653.797 (Dosja IX, f. 498-502).

- (20) 20.09.2010 në orën 14:06:05 Y. V. +386 (0)49-369-468 thirri M.G. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.660.647 (Dosja IX, f. 534-537).
- (21) 21.09.2010 në orën 14:00:49 +386 (0) XXSMS nga Y. V. për M.G. +381 (0)XX, letërnjoftimi 1.662.376 (Dosja IX, f. 542-543).
- (22) 22.09.2010 në orën 20:41:24 M.G. +381 (0) 66-5094977 thirri Y. V. +386 (0)XX letërnjoftimi 1.664.147 (Dosja IX, f. 544-554).
- (23) 01.10.2010 në orën 17:20:55 M.G. +381 (0) XX thirri Y. V.n +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.682.208 (Dosja X, f. 573-576).
- (24) 01.10.2010 në orën 17:22:32 +386 (0) XX Y. V. thirri F.Z. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.682.213 (Dosja X, f. 577-578).
- (25) 01.10.2010 në orën 19:37:21 +381 (0) XX M.G. thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.682.360 (Dosja X, f. 582-585).
- (26) 04.10.2010 në orën 19:40:58 +381 (0) XX M.G. thirri Y. V. +386 (0)XX letërnjoftimi 1.685.273 (Dosja X, f. 592-596).
- (27) 07.10.2010 në orën 14:53:49 M.G. +49 (0) XX (kabinë telefonike publike) thirri Y. V.n +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.888.439 (Dosja X, f. 621-629).
- (28) 11.10.2010 në orën 11:26:26 Y.V. +386 (0) XX thirri M.G. 0EB02D0911770962708, letërnjoftimi 1.692.520 (Dosja X, f. 641-644).
- (29) 11.10.2010 në orën 14:09:01 Y. V. +386 (0) XX thirri M.G. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.693.768 (Dosja X, f. 645-647).
- (30) 11.10.2010 në orën 14:15:04 Y. V. +386 (0)49-369-468 thirri M.G. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.693.866 (Dosja X, f. 648-651).
- (31) 11.10.2010 në orën 14:35:19 Y. V. +386 (0)49-369-468 thirri M.G. +381 (0) X-xx, letërnjoftimi 1.694.161 (Dosja X, f. 652-654).
- (32) 11.10.2010 në orën 15:34:50 Y. V. +386 (0) XX thirri M.G. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.694.062 (Dosja X, f. 655-657).

(33) 11.10.2010 në orën 16:07:56, 16:08:12, 16:23:28, 16:56:01, 17:24:25 Y. V. +386 (0) XX tentoi të thërriste M.G. +381 (0) XX (Dosja X, f. 666-676).

Y. V./J., S.F., M.D. dhe F.Z. (pseudonimi B.)

(34) 13.08.2010 në orën 13:34:40 S.F. +381 (0) XX thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.487.445 (Dosja IX, f. 1-7).

(35) 13.08.2010 në orën 14:46:22 S.F. +381 (0) XX thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.487.508 (Dosja IX, f. 8-11).

(36) 14.08.2010 në orën 13.08.15 S.F. +381 (0) XX thirri Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.488.149 (Dosja IX, f. 18-21).

(37) 16.08.2010 në orën 02:25:09 F.Z. +49 (0) XX SMS një tjetri në Kosovë +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.489.130 (Dosja IX, f. 37-38).

(38) 17.08.2010 në orën 18.01.16 S.F. +381 (0) XX thirri Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.491.057 (Dosja IX, f. 78-81).

(39) 20.08.2010 në orën 14:58:07 +49(0) XX M.D. i dërgoi një tekst-mesazh S.F. +49(0) XX, letërnjoftimi 1.493.672 (Dosja IX, f. 97-98).

(40) 23.08.2010 në orën 21:32:38 S.F. +49(0) XX thirri Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.495.701 (Dosja IX, f. 144-146).

(41) 23.08.2010 në orën 22:31:22 një mashkull, i cili besohet të jetë Y. V. +386 (0)XX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.495.743 (Dosja IX, f.157-159).

(42) 23.08.2010 në orën 22:34:27 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +49(0) XX, letërnjoftimi 1.495.745 (Dosja IX, f. 160-163).

(43) 23.08.2010 në orën 22:55:41 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +49(0)XX, letërnjoftimi 1.495.761 (Dosja IX, f. 164-167).

(44) 24.08.2010 në orën 11:07:06 F.Z. (B.) +49 (0) XX SMS një tjetri në Kosovë +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.495.931 (Dosja IX, f. 170--171).

- (45) 24.08.2010 në orën 11:49:40 thirrje nga një mashkull i panjohur në një numër të Kosovës +386 (0)XX to F.Z. +49 (0)XX, letërnjoftimi 1.495.958 (Dosja IX, f. 175--177).
- (46) 13.09.2010 në orën 15.13.28 S.F. +49 (0)XX thirri M.D. +49 (0)XX, letërnjoftimi 1.652.531 (Dosja IX, f. 469-470).
- (47) 13.09.2010 në orën 21:25:24 S.F. +49(0)XX (kabinë telefoni publike) thirri Y. V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.652.903 (Dosja IX, f. 473-478).
- (48) 13.09.2010 në orën 21:26:57 Y. V. +386 (0)XX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.652.904 (Dosja IX, f. 479-480).
- (49) 13.09.2010 në orën 22:59:37 S.F. (kabinë telefoni publike) thirri Y.V. +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.652.954 (Dosja IX, f. 481-484).
- (50) 14.09.2010 në orën 09:57:41 SMS nga F.Z. +49 (0) XX dërguar një tjetri në Kosovë +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.652.162 (Dosja IX, f. 485-486).

Y.J., M.O.dhe A.M.2 janar - 11 janar 2011

- (51) 02.12.2010 në orën 21:14:04 Y. V. +386 (0)XX thirri M.O.+49 (0)XX, letërnjoftimi 1.764.307 (Dosja X, f. 724-728).
- (52) 03.12.2010 në orën 13:27:33 M.O.+49 (0)XX thirri Y. V.n +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.764.694 (Dosja X, f. 746-749).
- (53) 10.12.2010 në orën 18:01:30 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.775.143 (Dosja X, f. 781-783).
- (54) 24.12.2010 në orën 17:51:19 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.782.566 (Dosja X, f. 797-798).
- (55) 02.01.2011 në orën 18:06:44 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.799.471 (Dosja X, f. 811-812).
- (56) 02.01.2011 në orën 20:40:23 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.799.542 (Dosja X, f. 813-814).
- (57) 02.01.2011 në orën 20:44:56 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.799.526 (Dosja X, f. 815-816).

- (58) 07.01.2011 në orën 20:47:51 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.801.438 (Dosja X, f. 825-826).
- (59) 10.12.2010 në orën 13:42:59 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.800.208 (Dosja X, f. 829-830).
- (60) 10.01.2011 në orën 18:25:20 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.340 (Dosja X, f. 833-834).
- (61) 10.01.2011 në orën 18:27:08 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.801.342 (Dosja X, f. 835-836).
- (62) 10.01.2011 në orën 18:29:15 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.344 (Dosja X, f. 837-838).
- (63) 10.01.2011 në orën 18:30:05 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.345 (Dosja X, f. 839-840).
- (64) 10.01.2011 në orën 18:33:08 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.352 (Dosja X, f. 841-842).
- (65) 10.01.2011 në orën 18:34:59 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y.V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.354 (Dosja X, f. 843-844).
- (66) 10.01.2011 në orën 18:37:07 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.360 (Dosja X, f. 845-846).
- (67) 10.01.2011 në orën 18:38:18 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.361 (Dosja X, f. 848-849).
- (68) 10.01.2011 në orën 18:42:36 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.364 (Dosja X, f. 850-851).
- (69) 10.01.2011 në orën 18:44:24 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.366 (Dosja X, f. 852-853).
- (70) 11.01.2011 at 08:46:14 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.502 (Dosja X, f. 854-855).

- (71) 11.01.2011 në orën 12:22:04 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.622 (Dosja X, f. 862-863).
- (72) 11.01.2011 në orën 12:28:41 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.625 (Dosja X, f. 864-865).
- (73) 11.01.2011 në orën 12:49:35 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.664 (Dosja X, f. 870-871).
- (74) 11.01.2011 në orën 12:51:18 Y. V. +386 (0)49-346884 i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0)157-84456383, letërnjoftimi 1.802.672 (Dosja X, f. 872-873).
- (75) 11.01.2011 në orën 14:17:28 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.836 (Dosja X, f. 878-879).
- (76) 11.01.2011 në orën 14:21:08 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.805 (Dosja X, f. 880-881).
- (77) 11.01.2011 në orën 14:25:13 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XXX, letërnjoftimi 1.802.868 (Dosja X, f. 882-883).
- (78) 11.01.2011 në orën 14:29:27 Y. V. +386 (0)49-346884 i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0)157-84456383, letërnjoftimi 1.802.880 (Dosja X, f. 884-885).
- (79) 11.01.2011 në orën 14:34:31 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.899 (Dosja X, f. 886-887).
- (80) 11.01.2011 në orën 14:29:27 Y. V. +386 (0) XX thirri M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.802.961 (Dosja X, f. 888-890).
- (81) 11.01.2011 në orën 15:02:13 Y. V. +386 (0) XX thirri M.O.+49 (0)XX, letërnjoftimi 1.802.984 (Dosja X, f. 891-894).
- (82) 11.01.2011 në orën 15:11:35 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.803.014 (Dosja X, f. 895-896).
- (83) 11.01.2011 në orën 18:37:47 deri në orën 19:00:02 Y. V. +386 (0) XX i bëri M.O. -it 9 thirrje të humbura +49 (0) XX (Dosja X, f. 897-906, 909-914).

(84) 11.01.2011 në orën 18:41:23 Y. V. +386 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh M.O.+49 (0) XX, letërnjoftimi 1.803.385 (Dosja X, f. 907--908).

Y. V./J., S.F. dhe një korrier i panjohur. 30 gusht 2010

(85) 30.08.2010 në orën 14:56:16 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.512.128 (Dosja IX, f. 218-221).

(86) 30.08.2010 në orën 16:39:59 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.512.236 (Dosja IX, f. 222-224).

(87) 30.08.2010 në orën 17:00:42 Y. V.+386 (0) XX thirri S.F. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.512.258 (Dosja IX, f. 227-229).

(88) 30.08.2010 në orën 17:25:00 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.512.275 (Dosja IX, f. 245-247).

(89) 30.08.2010 në orën 17:45:51 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.512.286 dhe, letërnjoftimi 1.512.285 (Dosja IX, f. 252-256).

Y.J., S.F. dhe M.O., 31 gusht – 2 shtator 2010

(90) 31.08.2010 në orën 14:10:00 Y. V. +386 (0) XX thirri S.F. +381 (0) XX, letërnjoftimi 1.564.806 dhe, letërnjoftimi 1.564.807 (Dosja IX, f. 313-315).

(91) 31.08.2010 në orën 16:32.01 S.F. +381 (0) XX thirri Y. V.n +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.564.954 (Dosja IX, f. 324-328).

(92) 31.08.2010 në orën 16:38:22 M.O.+49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.646.305 (Dosja IX, f. 334-335).

(93) 31.08.2010 në orën 17.07.20 S.F. +381 (0) XX thirri Y. V.n +386 (0)XX, letërnjoftimi 1.565.010 (Dosja IX, f. 343-346).

(94) 31.08.2010 ndërmjet 18:36:15 dhe 23:13:15 ka 10 tekst-mesazhe të pakapshme ndërmjet M.O.+49 (0) XX dhe Y. V. +386 (0) XX (Dosja IX, f. 353-372).

Y.J., F.Z. (pseudonimi 'B.') dhe A.M. (pseudonimi 'D.)

- (95) 05.10.2010 në orën 14:51:29 A.M. +49 (0) XX thirri Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.686.086 (Dosja X, f. 597-607).
- (96) 05.10.2010 në orën 15:53:36 A.M. +49 (0) XX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.686.198 (Dosja X, f. 608-611).
- (97) 05.10.2010 në orën 16:21:17 A.M. +49 (0) XX thirri Y. V. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.686.249 (Dosja X, f. 612-618).
- (98) 14.10.2010 në orën 16:45:32 A.M. +49 (0) XX thirri F.Z. (B.) +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.698.837 (Dosja X, f. 677-680).
- (99) 14.10.2010 në orën 17:17:48 F.Z. (B.) +49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh një personi të panjohur +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.698.903 (Dosja X, f. 681-682).
- (100) 14.10.2010 në orën 20:41:36 F.Z. (B.) +49 (0) XX i dërgoi një tekst-mesazh B.K. +386 (0) XX, letërnjoftimi 1.699.109 (Dosja X, f. 683-684).
- (101) 20.10.2010 në orën 19:25:34 Y. V. +386 (0) XX thirri F.Z. +49 (0) XX, letërnjoftimi 1.702.536 (Dosja X, f. 692-696).

Dokumentet e mëposhtme u përmbledhën gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të 18 korrikut 2013:

Dokumentet dhe raportet nga Dosja numër 6⁵:

- Shkresa numër 1, Vendim i Gjykatës që miraton transferimin e procedurës penale të PSRK-së, datë 22 gusht 2012;
- Shkresa numër 2, raporti hetimor i shërbimeve shtetërore penale bavareze, datë 11/04/11;
- Shkresa numër 3, analiza e sendeve të sekuestruara lidhur me M.G., datë 19 tetor 2010;
- Shkresa numër 4, Kërkim sipas kodit i procesit të hetimit të lëndëve narkotike kundër M.B., i kryer nga Qendra e Shkencës dhe Edukimit e Seksionit Federal të Administrimit të Financave, i Qendrës Zyrtare Shkencore dhe Teknike në Munich;
- Shkresa numër 5, Raporti penal i shërbimeve shtetërore penale bavareze, doganat, 11 tetor 2010;

⁵ Dosja nr. 1 është versioni origjinal në gjermanishte i dokumenteve/raporteve në Dosjen n3. 6

- Shkresa numër 6, proces-verbalet e kontrolleve të mjediseve, datë 11 tetor 2011;
- Shkresa numër 8⁶, Raporti i Hetimit kundër të pandehurit M.O., i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Bavareze për Kriminalitet, datë 11 janar 2011;
- Shkresa numër 9, lista dhe foto-albumi i M.O., datë 11 janar 2011; foto të automjeti Mercedes Benz; Paketat e shënuara me heroinë etj.;
- Shkresa numër 11⁷, Raporti Hetimor⁸ lidhur me A.M. dhe P.F., i përgatitur nga T.A. Kryekomisioner;
- Shkresa numër 12, Raporti Forensik-analiza e lëndëve narkotike, datë 4 prill 2011, i lëshuar nga Qendrës Arsimore dhe Shkencore e Qendrës Federale të Administrimit Financiar Shkencor, në Muni, analiza e lëndës narkotike;
- Shkresa numër 13, Proces-verbal i kontrollit të pronës së M.O. , më 11 janar 2011, i nënshkruar nga Inspektor Rickert;
- Shkresa numër 14, Proces-verbal i kontrollit të automjeti DBM lidhur me M.O., datë 11 janar 2011, i përgatitur nga oficer B.;
- Shkresa numër 16, raporti policor dhe raporti i kontrollit i datës 11 janar 2011 lidhur me banesën e F.Z. në Rrugën XX në XX, bashkë me listën e sendeve të sekuestruara p.sh. para të gatshme në shumën 64.645 euro, pasaportë, laptop etj.

Dokumentet dhe raportet nga Dosja numër 7⁹

- Shkresa numër 17, Proces-verbal i Kontrollit i Policisë lidhur me A.M., datë 11 janar 2011, i përgatitur nga z. G., Njësia e Përbashkët për Hetimin e Drogës, Bavaria e Jugut;
- Shkresa numër 18, Raporti Forensik i Analizës së Lëndës Narkotike të A.M., lidhur me procesin kundër A.M., datë 4 prill 2011, Institucioni i Qendrës Arsimore dhe Shkencore të Seksionit Federal të Shkencës së Menaxhimit Financiar dhe Teknik;
- Shkresa numër 19, Dokument lidhur me akuzën ndaj Y. J. , datë 19 prill 2012, shkëmbimi i informacionit ndërmjet EULEX-it dhe Drejtorisë Shtetërore Bavareze për Doganat Penale.
- Shkresa numër 20, Raporti Forensik i Analizës së Lëndës Narkotike lidhur me SH. F., datë 4 prill 2011, i përpiluar nga Doktor F., Qendrës Arsimore dhe Shkencore e Seksionit Federal të Shkencës së Menaxhimit Financiar dhe Teknik;
- Shkresa numër 21, Raporti Hetimor, datë 21 korrik 2011, i lëshuar nga Njësia Shtetërore të Përbashkët të Shërbimeve Penale të Bavarisë për Hetimin e Drogës kundër A.M.;
- Shkresa numër 22, Raport i Ekzaminimit të mobilëve të sekuestruar, datë 13 dhjetor 2012;

⁶ Shkresa numër 7 nuk u lexua sepse përmbante deklaratat e dëshmitarëve

⁷ Shkresa numër 10 nuk u lexua sepse kishte intervistën e M.O.

⁸ Raporti nuk kishte datë.

⁹ Dosja nr. 2 është versioni origjinal në gjermanishte i dokumenteve/raporteve në Dosjen nr. 7

- Shkresa numër 23, Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut të Munihut, (një romak) I, dënimet e G. - 10 vite dhe 4 muaj, A. - 6 vite, B. - 4 vite dhe 10 muaj. Në arsyetim gjykata flet për Y. V. Aktgjykimi ishte për vepra penale të lidhura me drogën;
- Shkresa numër 24, Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut të Munihut, (një romak) I, që është a Aktgjykim i lidhur me drogën me të cilin, F. mori dënimin me 10 vite dhe 10 muaj burgim dhe O. 8 vite. Arsyetimi i këtij Aktgjykimi përmend Y.J. shumë herë;
- Shkresa numër 25, Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut të Munihut, (një romak) I, kundër F.Z., i cili u dënua me 6 vite dhe 6 muaj burgim, me gjobë 20.000 euros, për veprën/vepra penales të lidhura me lëndët narkotike. Në arsyetim emri i Y. J. përmendet shumë herë.
- Shkresa numër 26, Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut të Munihut, (një romak) I, kundër A.M. për vepra të lidhura me drogën, i cili u dënua me 6 vite burgim. Name i Y. V. përmendet shumë herë në arsyetimin e Aktgjykimi;
- Shkresa numër 27, letër e W., që vetëm identifikon se personi më i informuar është TH.A.;
- Shkresa numër 28, Urdhër-arresti kundër Y. V., i lëshuar në Munih, më 15 dhjetor 2011, nga gjyqtari i gjykatës vendore;

Dokumentet nga Dosja numër 8-Raportet për përgjimet e urdhëruara nga autoritetet gjermane¹⁰.

Deklaratat e dëshmitarëve

Më 22 korrik 2013, dëshmitari A.S. Policia e EULEX-it, u dëgjua si dëshmitar përpara trupit gjykues. Ai u deklarua se kishte qenë në ngarkim të operacionit për arrestimin e të pandehurit Y.J. dhe dha informacion rreth procesit të kontrollit në mjediset e të pandehurit në Zonën e Sofalisë. Dëshmitari S. deklaroi se i pandehuri ishte plotësisht i informuar për të drejtat e tij dhe se fillimisht ai nuk donte të kishte mbrojtës të pranishëm. Megjithatë, pas pak ai vendosi të thërrasë Avokatin R.G.. Dëshmitari S. deklaroi se shtëpia në zonën e Sofalisë dukej se ishte e okupuar dhe jo vend i përkohshëm për të jetuar, se disa sende i përkisnin një mashkulli dhe një fëmije dhe brenda kishte dukat. Se kuzhina ishte plotësisht e pajisur prandaj ishte e dukshme se ata jetonin atje¹¹ dhe se në katin përdhes kishte një dhomë lojërash për fëmijë, dhe në katin e dytë një dhomë fëmijësh¹². Se bari i thatë i gjelbër i sekuestruar¹³ u dërgua tek Njësia Forensike, që rezultoi se ishte Marijuanë. Më tej, dëshmitari S. dha informacion rreth kontrollit tjetër të pronës së të pandehurit, një banesë në Rrugën XX, Prishtinë. Atje ata gjetën 10 telefona të

¹⁰ Dosja nr. 3 është versioni origjinal në gjermanishte i dokumenteve/raporteve në Dosjen nr. 8

¹¹ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, datë 22 korrik 2013, f. 7, përgjigja e dytë e pyetjes së prokurorit.

¹² Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, datë 22 korrik 2013, f. 7, përgjigja e tretë e pyetjes së prokurorit.

¹³ U sekuestrua edhe një orë Rolex, Audi Model A4, 2011, dhe një Golf 6, Model 2011

ndryshëm dhe 11 karta SIM, etj¹⁴, dhe se ata gjetën një pluhur që ishte i paketuar, dhe atje ata gjetën edhe një peshore elektronike¹⁵ dhe se pas dërgimit të pluhurit në Njësinë Forensike, u provua se ai ishte heroinë.

Dëshmitari dha gjithashtu shpjegim se të pandehurit nuk iu kërkua ta shpinte policinë në banesën në Rrugën XX, sepse kishte një urdhër gjykatë për kontrollin e saj¹⁶ dhe se krahas dy armëve të zjarrit dhe një arme gjuetie, 14 gramëve heroinë dhe një sasive marijuane, nuk u gjet asnjë send ose mall tjetër që në rrethana normale një person nuk do të duhej ta posedonte¹⁷. Dëshmitari S. gjithashtu deklaroi se telefonat dhe SIM-kartelat e sekuestruara ia kishte dërguar IT-së forensike për ekzaminim dhe ai nuk kishte informacion rreth rezultatit të ekzaminimeve, dhe se ai nuk ishte përfshirë në hetimin kundër të pandehurit në Kosovë, sepse të gjitha kontrollet vareshin nga dokumentet e ndihmës ligjore ndërkombëtare nga Gjermania¹⁸.

Dëshmitari S. u përgjigj në pyetjet e Mbrojtësit R.G., Mbrojtësi i dytë i të pandehurit Y.J., që disa prej tyre ishin në lidhje me orën Rolex dhe automjetet që u sekuestruan gjatë operacionit të kontrollit. Dëshmitari S. kujtoi që i pandehuri kishte thënë se ai ka një shtëpi në Shtimje dhe se ai personalisht nuk pyeti se kush ishte pronari i shtëpisë në Sofali¹⁹. Dëshmitari S. deklaroi gjithashtu se policia nuk e dinte cila derë ishte, por nuk e pyeti të pandehurin për adresën e banesës së ndodhur në Rrugën 'XX, sepse adresa e saktë ishte dhënë në Urdhrin e Kontrollit²⁰.

Në pyetjen e të pandehurit, dëshmitari S. deklaroi se e kishte parë të pandehurin duke lexuar ose duke pretenduar se lexonte dokumentet e paraqitura, por mban mend gjithashtu se e ka dëgjuar atë të thotë se ai është më mirë në gjermanishte. Më tej, dëshmitari S. tha se i pandehuri nuk dëshironte mbrojtës prezent gjatë kontrollit dhe se nuk është e vërtetë se të pandehurit iu tha se pritja deri sa të mbërrinte mbrojtësi do të merrte shumë kohë, prandaj ai do të ishte prezent në kontroll²¹. Dëshmitari S. gjithashtu deklaroi se e kishte dëgjuar të pandehurin të thotë se shtëpia në Sofali u përkiste prindërve të tij. Megjithatë, të gjitha sendet e gjetura atje tregonin se shtëpia ishte e okupuar nga i pandehuri²². Kur u pyet, dëshmitari S. deklaroi se kishte vrojtuar se i

¹⁴ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 11, përgjigja e pestë e pyetjes së prokurorit.

¹⁵ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, datë 22 korrik 2013, f. 11, përgjigja e nëntë e pyetjes së prokurorit

¹⁶ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 13, përgjigja e dytë të pyetjes së mbrojtësit kryesor të të pandehurit, z. J.

¹⁷ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 13, përgjigjet e pestë dhe e gjashtë e pyetjeve të mbrojtësit kryesor të të pandehurit, z. J.

¹⁸ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 13, përgjigjet e tetë dhe e nëntë të pyetjeve të mbrojtësit kryesor të të pandehurit, z. J.

¹⁹ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 14, përgjigja e parë në pyetjen e mbrojtësit të dytë të të pandehurit, z. R. G.

²⁰ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 14, përgjigjet e dytë, e tretë, e katërt dhe e pestë e pyetjes së mbrojtësit të dytë të të pandehurit, z. R. G.

²¹ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 16, përgjigja e dytë, e tretë, e katër dhe e pestë në pyetjen e të pandehurit.

²² Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 16, përgjigja e gjashtë në pyetjen e të pandehurit.

pandehuri nuk përballej me ndonjë vështirësi shëndetësore²³. Lidhur me pyetjen se i pandehuri nuk dëshironte të nënshkruante ndonjë dokument, Dëshmitari u përgjigj se i pandehuri e bëri të qartë se ai nuk do të nënshkruante asnjë dokument.

Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues, dëshmitari konfirmoi se i pandehuri ishte prezent kur policia gjeti lëndët narkotike dhe shtoi se i pandehuri u skuq në fytyrë dhe filloi të pinte cigare pas kësaj²⁴.

Dëshmitari A.O., oficer i policisë së Kosovës, deklaroi se kishte përpiluar një raport në lidhje me të dhënat financiare të të pandehurit. Raporti përmbante analizat e transaksioneve bankare të të pandehurit. Dëshmitari O. shpjegoi se kishte pasur disa transaksione të dyshimta, sepse nuk dihet ku përfunduan paratë, pasi u tërhoqën shuma të mëdha parash²⁵.

Pas kërkesës për ndihmë ligjore ndërkombëtare dërguar autoriteteve gjermane, **dëshmitari TH.A., oficer i policisë gjermane**, u dëgjua, përmes video-linkut, në cilësinë e dëshmitarit.

Në pyetjet e Prokurorit, dëshmitari A. deklaroi se kishte filluar një operacion që kishte rezultuar me arrestimin e një personi të quajtur Z. në prill 2010, dhe sekuestrimin e 5kg heroinë. Pas kësaj, në korrik 2010, Njësia Hetimore Rajonale e Bavarisë dhe ai si udhëheqës i grupit, nisën hetimet lidhur me njerëzit që banonin në Kosovë dhe fill pas kësaj, bazuar në përgjimet e telekomunikimeve, Njësia Hetimore përcaktoi se një grup njerëzish ishin përfshirë në veprimtari kriminale dhe se Y.J. u identifikua si furnizuesi i drogës. Se Njësia Bavareze identifikoi edhe blerësit e drogës në Munihi dhe rrethina, saktësisht një person të quajtur M.G., në E.B. Landshut, P.F., nga Augsburgu, M.O.dhe M.D. në Munihi. Se ata identifikuan edhe një shtetas kosovar të quajtur F.Z., roli i të cilit ishte të mblidhte paratë nga blerësit dhe t'i transferonte ato para në Kosovë tek një person i quajtur B.K., dhe ky më pas ia transferonte ato Y. J. Dëshmitari A. deklaroi se kjo ishte struktura e grupit të organizuar kriminal dhe se Njësia Bavareze e vërtetoi këtë bazuar në përgjimin e telekomunikimeve.

Dëshmitari A. përshkroi gjithashtu arrestimin e një personi nga Kosova, i cili mendohej se e furnizonte me heroinë M.G.- in dhe se këtë e tregonin edhe disa biseda të përgjuara, të zhvilluara ndërmjet Y. J. dhe G. Se arrestimi ndodhi më 11 tetor 2011, ku policia kontrollloi një Mercedes të kuq brenda të cilit ndodheshin z. B. dhe z. A., të cilët gjithashtu u arrestuan, dhe se ata gjetën 4.5 kg heroinë në pjesën e përparme të majtë të veturës. Dëshmitari A. i tregoi gjithashtu Gjykatës së në banesën e M.G. u sekuestruan një sasi e mbetur prej 50 (pesëdhjetë) gramësh heroinë nga dërgesa e mëparshme, 5,000 (pesë mijë) euro para të gatshme, që ishin përgatitur për korrierët, siç ishte rënë dakord tashmë ndërmjet Y. J. dhe G., dhe korrierët ishin informuar rreth kësaj. Se ishin sekuestruar edhe mobilë të përdorur nga M.G. dhe ata kishin SIM kartela IPKO. Dëshmitari

²³ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor datë, 22 korrik 2013, f. 17.

²⁴ Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, datë 22 korrik 2013, f. 19

²⁵ Për më shumë hollësi shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor datë 11 shtator 2013

A. deklaroi gjithashtu se kishte gjetur pasaportën e G.-ut dhe një vulë të datës 28 maj 2010, nga Kosova, dhe se kishte gjetur edhe një kalendar të M.G. ku ai kishte shënuar emrin e V. me dy numra telefoni, që i përkisnin familjes J., të cilët jetonin në XX, afër Munihut.

Lidhur me rolin e B. dhe A., dëshmitari A. deklaroi se ata ishin punësuar të dy si lëvrues të drogës nga Y.J., i cili duhej ta sillte drogën nga Kosova në XX, afër Munihut.

Dëshmitari A. deklaroi se më 11 janar 2011, M.O. u arrestua bashkë me P.F. në Rrugën XX, Munih. Se para arrestimit ata vrojtuan se si M. hipi në veturën²⁶ e z. O. dhe i dha atij 2 kg heroinë, dhe në këmbim ky e pagoi atë 37,000€ (tridhjetë e shtatë mijë) dhe se arrestimi u bë në pompën e gazit E. rreth 2 km larg vendit ku ndodhi ky dorëzim i drogës. Se heroina, që u provua se kishte pastërti të dobët, ishte nën ulësen e vozitësit, në një qese plastike, në katër paketa të veçanta, secila me 500 gramë. Se ajo që i kishte bërë ata të mbikëqyrnin M.O. ishte një kontakt telefonik i mëparshëm shumë i shpeshtë ndërmjet M.O. dhe Y. J., dhe se përmes tekst-mesazhit me Y.J. M.O. porosi 3 kg heroinë, por J. ofroi nga ana e tij vetëm 2kg për 37,000€.

Se fill pas arrestimit të M.O. , ata vazhduan të mbikëqyrnin z. M., i cili ishte në kontakt me F.Z. në Munich, për t'ia dorëzuar paratë Z.R. Se ata e arrestuan z. M. pas dorëzimit të parave në restorantin ose barin e z. Z. , në Munih, Rruga XX, në Munih. Se më pas z. R. dha një deklaratë dëshmitari ku ai deklaroi se ia kishte dhënë paratë F.Z. , i cili i dërgoi paratë në shtëpinë e tij në Rrugën XX, dhe se pas kryerjes së kontrollit të shtëpisë, ata gjetën 64,600 € dhe përfshirë 37,000€ e përmendura më parë. Policia kreu kontroll të shtëpisë së M. dhe ata gjetën 320 gramë heroinë.

Se gjatë hetimit të M.O., atij iu sekuestruan një numër mobilësh²⁷ dhe pas analizimit të tyre, policia gjeti se ai kishte ruajtur disa të dhëna kontakti të Y. J. nën emrin 'O.. Në lidhje me këtë dëshmitari A. deklaroi se kishte përgatitur një raport për analizat e të gjithë mobilëve të marrë gjatë hetimit.²⁸

Dëshmitari A. dha gjithashtu informacion për modus operandi të M.G. dhe M.O. Se G. komunikonte drejtpërdrejt me të pandehurin, dhe se M.O. varej nga z. M. Se kishte një ndryshim në mënyrën se si merreshin paratë dhe se si ktheheshin, sepse M.O. lejohej të porosiste drejtpërdrejt nga J. në Kosovë, por atij nuk i lejohej t'ia dorëzonte paratë drejtpërdrejt z. Z., sepse ato duhej të shkonin përmes F. (si distributor i J.), i cili pastaj duhej t'ia jepte ato z. Z.. F.Z. në periudhën ndërmjet korrikut 2010 dhe janarit 2011, u përfshi në të gjitha dërgesat tek Y.J.. K.G. , O., F., C., ishte dhe një person tjetër, A.M., në Munih, i cili kishte marrë 3kg heroinë nga Y.J.. Se, bazuar në hetimin dhe materiale të tjera, Y.J. vërtet furnizoi një sasi të madhe heroinë

²⁶ Mercedes Klasa M, me tablla të Munihut.

²⁷ Ato ishin sekuestruar në lokacione të ndryshme; një ai e kishte me vete dhe të tjerët ishin në shtëpinë e tij.

²⁸ Ky raport iu dërgua Republikës së Kosovës bazuar në kërkesën për NLN për transferimin e procedurës penale nga Republika Federale e Gjermanisë.

dhe se të gjitha dërgesat në periudhën e hetimit ishin rreth 22.5 kg heroinë. Dëshmitari A. dha informacion të veçantë lidhur me sasinë e drogës për furnizimin e të gjithë personave të përfshirë si zj. Z., nga prilli 2010 ishte 2.5 kg heroinë, M.G. sipas deklaratës së tij, mori 500 g heroinë në qershor 2010 dhe pastaj më 16 gusht 2010 5kg, plus 4.5 kg nga sekuestrimi i përmendur më parë (gjithsej 10 kg); S.F. mori më 30 gusht 2010 5kg heroinë. Se nga sasia e përmendur 5kg nga F., O. mori 3kg, dhe se krahas kësaj ai kishte 2kg nga 11 janari 2011. Zj M.D.²⁹ mori 400g heroinë, nga këto 5kg nga z. F. Se, megjithëse duhet të ketë qenë para korrikut 2010, momenti i saktë është i paditur, por ata zbuluan se A.M. mori 3kg heroinë nga J. Se vlera në rrugë e 1 gram heroinë në cilësinë 10% do të ishte rreth 50€ dhe se në periudhën e hetimit J. iu paguan 271,000€.

Dëshmitari A. dha gjithashtu informacion rreth shqyrtimit gjyqësor të mbajtur në Gjermani. Se shqyrtimi gjyqësor u krye në Gjykatën e qarkut në Munih në korrik 2010 ku dëshmitari A. dëshmoi dhe paraqiti përgjimet telefonike. Dëshmitari A. konfirmoi gjithashtu se në deklaratën e tij të datës 12 qershor 2013, ai kishte listuar një numër përgjimesh dhe se M.G. kishte konfirmuar se ato biseda ishin kryer ndërmjet atij vetë dhe J. dhe se ato përgjime ishin ato që ai ia luajti M.G. në gjykatën në Gjermani.

Në pyetjen e Mbrojtësit Z.J., dëshmitari A. deklaroi se identifikimi i Y. J. u bë bazuar në disa pika. Se ai u bë bazuar në deklaratën e M.G., i cili tha se kishte pasur një partner tregtar të quajtur J. V., dhe përmes procedurës së identifikimit me foto-rreshtim, kur u mor deklarata e A. M., në të cilën ky i fundit vërtet e njohu Y. V. J.. Se edhe gjatë hetimeve në Gjermani, dërgesat vazhdonin, megjithëse ishin arrestuar disa njerëz dhe se i pandehuri J. e ndryshoi numrin e tij të telefonit dhe se dërgesat vazhduan dhe se ky biznes ishte marrë në dorë nga F.B.

Në pyetjen e Mbrojtësit R.G., dëshmitari A. deklaroi se nuk kishte qenë në Kosovë dhe se kurrë nuk kishte pasur kontakt me Y.J. në lidhje me këtë çështje. Se kishte pasur urdhra gjykate për përgjimet kundër Y. J. në zonën e Gjermanisë. Se asnjë automjet që i përkiste J. nuk ishte ndaluar ndonjëherë, ose se nuk ishin gjetur droga në të. Se Y.J. kishte jetuar në Munih dhe rrethina në vitin 2004 dhe se kishte pasur disa shqyrtime gjyqësore dhe dënime të Y. J. për tregtimin e heroinës. Dëshmitari A. gjithashtu deklaroi se nuk kishte informacion rreth llogarive bankare të të pandehurit J., sepse të gjitha transfertat e parave ishin kryer duke ia dorëzuar paratë z. Z. Se të gjitha qeset plastike ishin analizuar për ndonjë analizë ADN-je dhe gjurmësh të gishtërinjve, po ato nuk kishin dhënë asnjë rezultat.

Në pyetjet e Kryetarit të Trupit Gjyqësor, dëshmitari A. u përgjigj duke deklaruar se nuk ka zhvilluar ndonjë hetime kundër nënës apo babait të të pandehurit J.. Se më vonë u zhvillua një hetim kundër A. V., i cili është vëllai i të pandehurit dhe Z K., i cili është kunati i tij. Dëshmitari

²⁹ Ajo ishte arrestuar në shtator 2011 dhe të 400 g e sekuestruar prej saj nuk kishin lidhje me hetimin për të cilin po fliste dëshmitari, por u provua se ato 400 g kishin qenë pjesë e të 5 kg nga F.

A. spjegoi gjithashtu si është zhvilluar rreshtimi fotografik kur është marrë në pyetje A. M. dhe, gjithashtu i tha Trupit Gjykses se ky i fundit është shpallur fajtor dhe dënuar me 7.5 vjet burgim. Se përveç A.M. edhe M.O. kishte identifikuar Y.J. si ai që ishte përfshirë në shitjen e heroinës megjithëse ai nuk e dinte emrin e shpërndarësit por ai e kishte njohur Y. V. më parë sepse ata kishin jetuar në të njëjtën zonë në Munih.

Deklaratat e M.L.

Në pyetjet e prokurorit dëshmitari M.L., oficer policie gjerman, u përgjigj duke deklaruar se kishte punuar 2 vjet në misionin në Kosovë si udhëheqës ekipi në njësinë e krimit të organizuar. Se ai kishte udhëhequr Ndhmën Juridike Ndërkombëtare që ishte dërguar nga Gjermania lidhur me hetimin kundër Y. J. i cili ishte filluar nga Policia Kriminale e Bavarisë. Se ai nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt në lëndën kundër Y. J. në Gjermani dhe se kishte patur kontakte të drejtpërdrejta me hetuesin udhëheqës të kësaj lënde në Gjermani. Përsa i përket operacionit Marimanga, dëshmitari L. tha në gjykatë se ky operacion kishte filluar në vitin 2009 dhe se kishte vazhduar deri në vitin 2010-2011 dhe se kishte të bënte me Y. J., shitje dhe trafikim droge nga Kosova në zonën e Munihut. Se lënda ishte në vazhdim e sipër për disa muaj dhe se lidhur me këtë lëndë ishin ndërmarrë edhe masa të fshehta duke përfshirë përgjimet të cilat kanë rezultuar në arrestimin dhe konfiskimin e sasive të mëdha të heroinës. Dëshmitari L. deklaroi se Policia Kriminale e Shtetit ishte duke hetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Y.J.si i dyshuari kryesor dhe se ai njihet si drejtuesi i trafikimit të heroinës të këtij grupi. Dhe se për këtë hetim që ishte në vazhdim e sipër, Prokuroria kishte lëshuar një urdhër-arrest ndërkombëtar kundër Y. J. Dhe se në bazë të provave të siguruara pas çështjes së Ndhmës Ndërkombëtare Ligjore, gjyqtari i procedurës paraprake pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kishte lëshuar një urdhër arresti të brendshëm dhe një urdhër kontrolli kundër Y.J. Lidhur me operacionin e bastisjes, dëshmitari Lindner deklaroi se ditën e kontrollit të shtëpisë në Sofali ishte ai i cili më vonë kishte hyrë brenda dhe i kishte spjeguar të drejtat sipas urdhër arrestit dhe i cili i kishte vënë prangat Y.J. Se ai kishte qenë ai që i kishte dorëzuar urdhër arrestin Y.J. sapo kishin hyrë në dhomën e ndenjjes dhe ia kishte spjeguar këtë në gjuhën gjermane dhe në veçanti e kishte këshilluar se kishte të drejtë të ndihmohej nga një avokat mbrojtës dhe se mund t'i caktohej një avokat por ai kishte refuzuar.

Se pasi kishte përfunduar kontrollin e shtëpisë në lagjen Sofali, ai dhe kolegët e tij kishin vozitur në rrugën “XX” ku ishte banesa e dytë e të pandehurit me qëllim që të kontrollonin këtë banesë sipas urdhrit të kontrollit lëshuar nga gjykata në Prishtinë. Se ata kishin kërkuar edhe dy dëshmitarë dhe se gjatë kontrollit ishte gjetur një sasi pudre në banjo sepse është e zakonshme që vendi ku fshihet droga është depozita shkarkuese e ujit të tualetit. Se ai kishte hequr mbulesën plastike që ishte në mur dhe kishte gjetur një qese të vogël plastike me pudër ngjyrë kafe e cila në bazë të erës dyshohej të ishte heroinë. Se në bazë të dosjes së lëndës M.Y.J. përmendet si udhëheqësi dhe organizatori i trafikimit të drogës.

Se M.G. ishte njëri prej pranuesve kryesorë të drogës nga Y.J. dhe ai ishte dënua me 10 vjet dhe gjashtë muaj burgim dhe se ai nuk kishte informata se pse M.G. kishte refuzuar të jepte deklaratë atij vetë dhe kolegut të tij A. Se M.O. është dënua gjithashtu me shumë vjet burgim sepse edhe ai është përfshirë me pranimin e drogës nga Z. J..

Në pyetjet e Avokatit Mbrojtës, Z.J., dëshmitari L. u përgjigj duke deklaruar se ka parë tabelën në dosjet e lëndës në Gjermani dhe se sipas asaj tabele Y.J. ishte vendosur në krye dhe se ishte përmendur si organizatori. Se i pandehuri kishte bashkëpunuar gjatë procedurës së kontrollit por se asistenca apo ndihma e tij nuk ishte e nevojshme përveç çelësit për të hyrë në banesën në rrugën "XX".

Në pyetjet e avokatit mbrojtës, R.G., dëshmitari L. u përgjigj duke deklaruar se ai kishte marrë përgjigje nga i pandehuri se shtëpia në lagjen Sofali është e prindërve të tij, se atij nuk i kujtohej nëse kishte marrë ndonjë përgjigje nga zyra kadastrale lidhur me pronësinë e shtëpisë. Se të gjitha gjërat që ishin konfiskuar, përveç çiftes, ishin në pronësinë e tij sepse i pandehuri nuk e kishte kontestuar këtë. Se dy makinat që ishin gjetur para shtëpisë, Audi A6, modeli më i ri, i cili vozitej nga vetë i pandehuri dhe Golf Model 5 i vozitej nga bashkëshortja e tij. Se dokumenti i regjistrimit të makinës tregonte se makina Golf 6 ishte e bashkëshortes së tij dhe se makina A6 i takonte një personi tjetër por se ai nuk ishte i sigurt sepse nuk e kishte dokumentin para tij. Dëshmitari nuk ishte në gjendje të kujtonte numrat e telefonëve përdorur nga i pandehuri Y.J. Se përveç kërkesës për t'i telefonuar bashkëshortes së tij, e cila ishte pranuar, i pandehuri Y.J. nuk kishte bërë ndonjë kërkesë tjetër të veçantë dhe se gjatë masës së paraburgimit i pandehuri ishte vizituar nga një doktor sepse ata kishin vërë re se i pandehuri kishte probleme me varësinë nga droga. Se familja e të pandehurit kishte një dyqan kopshtarie apo pronë afër Munihut.

Në pyetjet e Kryetarit të Trupit Gjykses, dëshmitari L. u përgjigj duke deklaruar se ai nuk kishte informata lidhur me origjinën e drogës dhe se cilësia e heroinës ishte mesatare në të ulët, dhe se ishte 10-12%. Se heroina e konfiskuar në Gjermani ishte substancë me bazë 12% dhe se ishte cilësi shumë e keqe. Se dikush mund të bëhet vartës i heroinës brenda një kohe shumë të shkurtër, dhe përse i përket sasisë së gjetur në shtëpinë e J.ai deklaroi se meqenëse i pandehuri J. ka mundësi të blejë këtë sasi mund të thuhet se kjo sasi ishte për përdorim personal. Se përse i përket çmimit e gjitha varet nga qyteti sepse situata dhe çmimi ndryshojnë madje edhe në Gjermani, dhe për këtë cilësi të ulët prej 12%, çmimi i përafërt është 100-140 euro për gram.

Ekspertiza dhe dëshmitarët ekspertë

Ekspertiza e zërit

Më datë 10 tetor 2013, Trupi Gjykses pranoi Raportin e Ekspertit Teknik përgatitur nga eksperti L.R. Profesor R. kishte pasur në dispozicion 2 CD: CD-ja e parë (1) (Original A)- mostër e zërit marrë nga i pandehuri Y.J. më datë 7 gusht 2013 dhe një (1) CD – biseda të përgjuara– Y.J..

Lista e Telefonëve të Përgjuar (bisedat e përgjuara në CD) u propozua të krahasohej me mostrat e zërit të marra nga i pandehuri më datë 7 gusht 2013:

ID 1.488.368; ID 1.489.840; ID 1.489.954; ID 1.489.966; ID 1.490.011; ID 1.490.034;

ID 1.508.903; ID 1.508.987; ID 1.647.114; ID 1.650.798; ID 1.650.804; ID 1.650.805;

ID 1.650.858; ID 1.653.797; ID 1.664.147; ID 1.682.208; ID 1.682.360; ID 1.692.520;

ID 1.693.768; ID 1.693.866; ID 1.694.161; ID 1.694.062; ID 1.764.307; ID 1.764.694;

ID 1.802.961; ID 1.802.984; ID 1.686.086; ID 1.686.249.

CD përmbante përgjime të bisedave, shumica e të cilave në gjuhën gjermane por aty kishte edhe disa në gjuhën shqipe.

CD e mostrës së zërit marrë nga i pandehuri Y.J. përmbante zërin e të pandehurit në të cilën atij iu kërkua të fliste në të dyja gjuhët, edhe në gjermanisht edhe në shqip.

Eksperti duhej të bënte krahasimin mes përgjimit të bisedës ‘zërat gjermanë’ me mostrën e zërit gjatë së cilës të pandehurit i ishte kërkuar të fliste në gjuhën gjermane dhe bisedat e përgjuara ‘zërat shqip’ me mostrat e zërit ku të pandehurit i ishte kërkuar të fliste në gjuhën shqipe.

Për qëllimet e kësaj ekspertize, profesor R. etiketoi Zërin e Njohur³⁰ si audio000003-bisedat në gjuhën gjermane, dhe audio000002-bisedat në gjuhën shqipe³¹. Për më tepër, raporti tregon se ID origjinale janë përkthyer me Etiketat p.sh. origjinali ID 1.488.368 si Etiketë/Progresive 368 dhe në vazhdim, dhe se kjo është bërë me qëllim që të lehtësohet leximi³².

Në raportin e tij profesor R. thekson se ai nuk kishte marrë në konsideratë disa biseda sepse ato nuk përmbushnin kushtet për sa i përket kohëzgjatjes³³. Me fjalë të tjera, këto biseda nuk përmbushin kohëzgjatjen për t’i analizuar sepse nuk ishin të gjata aq sa duhej. Raporti paraqet informata edhe për sa i përket metodës së aplikuar në Raportin e Ekspertit Teknik³⁴.

Profesor R. në përfundimet e tij gjen se në bazë të krahasimit mes zërit të njohur të Y. J.dhe zërit anonim³⁵ të të pandehurit Y.J. është identifikuar se ka folur në tetë(8) biseda; gjashtë (6) në gjuhën gjermane dhe 2 në gjuhën shqipe³⁶. Gjetjet janë mbështetur si në vijim:

Prova të forta se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000003 dhe zëri i panjohur etiketuar si A_368 i takojnë të njëjtit folës.

³⁰ Zëri i njohur është CD që përmban mostrat e zërit në seancën e datës 7 gusht 2013.

³¹ Spjegimi dhënë në fund të faqes 11 dhe tabela në faqen 12.

³² Faqe 11 e raportit– Tabela

³³ Në fund të faqes 15 dhe fillimi i faqes 16 Raporti i Ekspertit Teknik

³⁴ Faqet 8-10 të Raportit, B1.1-Metoda e aplikuar në raportin aktual

³⁵ Zëri anonim është Lista e bisedave telefonike nga CD –bisedat e përgjuara për përdorim nga Eksperti i Zërit

³⁶ Faqe 54-55 e raportit

Provë mesatarisht e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000003 dhe zëri anonim etiketuar si A_114 janë të të njëjtit folës.

Provë mesatarisht e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000003 dhe zëri anonim etiketuar si A_208 janë të të njëjtit folës.

Provë mesatarisht e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000003 dhe zëri anonim etiketuar si A_520 janë të të njëjtit folës.

Provë shumë e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000003 dhe zëri anonim etiketuar si A_307 janë të të njëjtit folës.

Provë e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000003 dhe zëri anonim etiketuar si A_ janë të të njëjtit folës.

Provë mesatarisht e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000002 dhe zëri anonim etiketuar si A_086 janë të të njëjtit folës.

Provë mesatarisht e fortë se zëri i njohur i Y. J. etiketuar si audio000002 dhe zëri anonim etiketuar si A__249 janë të të njëjtit folës.

Faqet 122 – 150 të raportit përmbajnë transkripte të tetë bisedave.

Gjendja mendore e të pandehurit–ekspertiza psikologjike-psikiatrike

Në bazë të Vendimit të Trupit Gjykses, Paneli i Ekspertëve ka kryer intervistë klinike psikiatrike dhe psikologjike me të pandehurin Y.J. në lokalet e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë më datë 03.10.2013 mes orës 14.30 dhe 15.00. Intervista të tjera u zhvilluar në ndërtesën e Klinikës Psikiatrike në Prishtinë, më datë 11.10.2013 nga ora 10 deri në orën 12, dhe më datë 17.10.2013, nga ora 10.00 deri në orën 11.30.

Përsa i përket kësaj çështjeje, Gjykata pranoi një raport dhe, gjithashtu edhe disa përgjigje shtesë të pyetjeve të shtruara nga Avokati Mbrojtës, R.G. Për më tepër, Paneli i Ekspertëve u dëgjua gjatë seancës së datës 13 nëntor 2013³⁷. Ekspertët shpjeguan se ata kishin kryer disa herë ekzaminime dhe se kishin bërë edhe mini testin e perceptimit. Ata kishin zhvilluar edhe ekzaminimin e quajtur testi koherent dhe ai jo koherent, si dhe proceset e arsyetimit të të pandehurit, të cilat janë pjesë e aftësive të tij mendore. Është deklaruar se lidhur me proceset e perceptimit, mënyra si i pandehuri mendon, se mënyra e të menduarit nga ana e tij ishte logjike, dhe se Ekspertët nuk kishin gjetur ndonjë proces patologjik në përmbajtjen e mendimeve të tij. Aty ishte thënë gjithashtu se ata nuk kishin gjetur ndonjë çrregullim lidhur me gjendjen e tij, asnjë lloj çrregullimi në perceptimin e tij, si p.sh iluzion apo halucinacion, gjendja e tij emocionale ishte në kontroll, si dhe procese të tjera të inteligjencës si p.sh llogaritja dhe të tjera ishin normale. Prandaj, është arritur në përfundimin se gjendja e tij mendore është më se

³⁷ Psikologe e EULEX-it, H.K., u dëgjua e para, më pas u dëgjua Prof. Dr. Z.H. dhe e fundit ishte Dr. N.I. M.

normale. Prof. Dr. Z.H. shoti se “Shkenca thotë, dhe në bazë të përvojës time të gjatë, se disa persona të cilët kanë qenë përdorues droge për një kohë të gjatë, këta persona tregojnë dallime në procesin e perceptimit, megjithatë, kjo është çështje trashëgimie dhe kjo varet nga brishtësia e sistemit nervor qendror. Pra si përfundim, pas shumë ekzaminimeve nuk gjetëm ndonjë patologji në statusin psikiatrik të të pandehurit”.

III. Propozimet për prova të cilat janë hedhur poshtë

Trupi Gjykses hodhi poshtë propozimet e mëposhtme:

- Kërkesën e prokurorit të lëndës për të pranuar dhe lexuar si provë deklaratën e M.G. dhe M.O. Trupi Gjykses arriti në përfundimin se këto deklarata nuk mund të përdoren në këtë gjykim sepse të dy ishin marrë në pyetje në cilësinë e të dyshuarve/pandehurve.
- Kërkesa e avokatit mbrojtës, R.G., për të dëgjuar si dëshmitarë të gjithë të pandehurit e dhe një numër tjetër personash. Trupi Gjykses vendosi në këtë mënyrë sepse avokati G. nuk ka dhënë emrat e saktë të individëve por tha vetëm ‘të gjithë personat e përfshirë në këtë lëndë’ dhe se ai nuk siguroi sqarim të arsyeshëm mbi arsyen se për çfarë do të dëshmonin dhe vërtetonin këta persona në këtë gjykim.

Dëshmitarët të cilët refuzuan të dëshmojnë përmes lidhjes me video:

Më datë 16 korrik 2013, Gjykata dërgoi një KNJN autoriteteve gjermane duke kërkuar ndihmë për të ftuar zyrtarisht M.G. dhe M.O. për të dëshmuar në gjykatë. Gjykata pranoi informata se asnjë prej tyre nuk ishte i gatshëm të dëshmojë dhe se sipas ligjit gjerman ata nuk mund të detyroheshin të dëshmonin. Gjykata nuk siguroi deklaratat e tyre për shkak të mosgatishmërisë së tyre dhe për faktin se ato ishin të tepërta.

IV. Akuza e hedhur poshtë Pronësia, Kontrolli, Posedimi apo Përdorimi i Armëve, në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 KPK

Y.J. u akuzua se më datë 2 tetor 2012, Y.J. kishte kryer në territorin e Kosovës veprën penale të pronësisë, kontrollit apo posedimit të armëve që kishte në pronësi, se kishte kontroll apo se posedonte tre armë, përkatësisht, një armë cilindrike e gjuetisë Kratay Magnum, numër serik XX si dhe municion, një pistoletë me gaz Ekol Tuna, numër serik XX si dhe municion, dhe një pistoletë me gaz Ekol Special-99, numri serik XX si dhe municion. Ky akt mbulohet nga Ligji mbi Amnistinë Nr. 04/L-2090, Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.10 .

V. Gjetjet faktike

Trupi Gjykses, pas përfundimit të seancës gjyqësore dhe pas administrimit të provave gjeti, se i pandehuri Y.J. ishte përfshirë në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja

e paautorizuar e drogave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotropike në kundërshtim me Nenin 229, par. 1, 2, 3 Kodi Penal i Kosovës (kodi penal i mëparshëm i vlefshëm deri më datë 31/12/2012) dhe, veprën penale të krimit të organizuar sipas Nenit 274 paragrafi 3 Kodi Penal i Kosovës (i vlefshëm deri më datë 31 dhjetor 2012).

Përgjegjësia penale

Sugjerimi i mbrojtjes për Gjykatën se i pandehuri duke qenë i varur nga narkotikët nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet e tij ishte i pasaktë dhe nuk është vërtetuar si i tillë. Raporti i Panelit të Ekspertëve ka treguar se personaliteti i tij nuk është ndikuar nga narkotikët dhe se nuk ka patur mungesë të përgjegjësisë penale. Se funksionimi mendor i tij ishte në nivel të tillë që ai ka kuptuar dhe kontrolluar shumë mirë veprimet e tij.

Përgjimet i atribuohen Y. J.

Gjithashtu, trupi gjykues nuk i besoi mbrojtjes së paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit se ai nuk ishte folësi i bisedave të përgjuara në mënyrë të ligjshme nga ana e autoriteteve gjermane. Megjithëse kjo ishte e qartë dhe mund të ishte përcaktuar madje edhe nga një vëzhgues objektiv se në të vërtetë ishte zëri i të pandehurit, megjithatë trupi gjykues, me qëllim që të mos linte vend për mendime të ndryshme, angazhoi një ekspert me përvojë për të dhënë përgjigje lidhur me këtë çështje. Ekspertiza konfirmoi se ishte i pandehuri Y.J. i cili fliste në tetë biseda. Për më tepër, përmbajtja e këtyre bisedave ishte në mënyrë të qartë e lidhur me drogë. Gjykata vëren se Eksperti i Zërit nuk kishte analizuar shumicën e bisedave në CD – biseda të përgjuara sepse ato nuk ishin të gjata aq sa duhej (që do të thotë se nuk kishin minimumin e kohëzgjatjes për vlerësim) megjithatë, kjo nuk minon gjetjet e tij. Kur zëri nga një numër telefoni i caktuar iu atribuua të pandehurit në bisedën tjetër në/nga ky numër, Y.J. u konsiderua nga trupi gjykues si pjesëmarrës. Përmbajtja e bisedës dhe deklarata e oficerit të policisë TH.A. i cili paraqiti rezultatet e hetimit në Gjermani mbështet një përfundim të tillë.

Vërtetimi i provave lidhur me dërgesat individuale

Periudha mes datës 27 gusht 2010 dhe datës 12 tetor 2010 lidhja G.

Ashtu siç është vërtetuar nga raporti i policisë gjermane dhe deklarata e dëshmitarit TH. A., policia gjermane pas përgatitjes së aksionit sekuestroi 4.56 kg (peshë neto) heroinë, e cila ishte në 9 pako nga kapaku i rrotës së parë të një makine Mercedes Benz klasë C, me targa sllovene XX në Munih, Gjermani më datë 11 tetor 2010. Ky veprim ishte përgatitur bazuar në përgjimet e telefonit(ave) të M.B.

Y. J. ka përshkruar G. (32) më 11.10.2010 në orën 15:34:50 nga numri +386 (0) XX drejt numrit +381 (0) XX ID 1.694.062 (Mbështjellësi X, pp. 655-657)) ngjyrën e kuqe të Mercedes Benz të lidhjes së tij. Menjëherë narkotikët janë sekuestruar në këtë makinë nga policia gjermane dhe korierë ishin (S.A.dhe J.B.). Biseda para aksionit të policisë tregon se dërgesa ishte

koordinuar në mes të G.- ut dhe J. Ky numër telefoni ishte përdorur nga Y.J. Është vërtetuar nga ekspertiza e L. R., profesor (shih vlerësimin e ekspertizës). Dëshmitari TH. A. ka deklaruar se M.G. – pjesëmarrës i grupit, gjatë gjykimit të tij pas ballafaqimit me këto përgjime ka konfirmuar se personi që ka biseduar me të është Y.J.

Angazhimi i F.Z. si korier është dëshmuar jo vetëm nga arrestimi i tij por mund të arrihet logjikisht te ky konkludim nga bisedat e përgjuara. Kjo bisedë e përgjuar definitivisht ka të bëjë me narkotikë. Biseda tregon se ka pasur edhe një dërgesë tjetër që nuk është kapur nga policia gjermane në këtë periudhë. Përgjimet tregojnë se si ka funksionuar “sistemi i ndarjes” në grup.

J. është degjuar duke organizuar dorëzimin e parave në mes të G. -ut dhe F.Z. në një degë të bankës në orën 11:30 dhe në orën 12:08:58, G.-u-u i ka thënë J.se ai kishte takuar “atë” (F.Z.), dhe J. pyeti, “çfarë ishte?” dhe G.u përgjigj “26”. Të njëjtën ditë, nëorën 20:31:28, F.Z. ka dërguar një mesazh SMS Bashkim Kamerollit me përmbajtjen “I. 25000”. Kjo seri e bisedave mund të interpretohet në atë mënyrë që G. -u ka paguar shumën prej €26,000 Z. në shkëmbim për heroin dhe pastaj Z. i ka treguar J. shumën që do t’i shkojë J. (€25,000) minus tarifa e Z. (një shumë e tillë është e lidhur me pozitën e Z. në grup).

Në mëngjesin e datës 11.09.2010, ka pasur kontak tjetër telefonik në mes të G. ut dhe J. në orën 10:35:44 ku G. -u-u i ka thënë J. se ai (G.) mund të takohet me një person mashkull tjetërZ pasi ky personi tjetër jeton afër në Milbertshofen, katër stacione larg (apartamenti i F.Z.gjendej në Milbertshofen). G. u ka diskutuar me J. takimin në orën 11.00 gjatë mëngjesit të njëjtë në pompën e benzinës X. Pastaj J. ka kontaktuar F.Z. në orën 10:38:14 ku ish-in dakorduar që G. -u të takohet me Z. nëorën 11.15 të njëjtin mëngjes. Në dy telefonatat e tjera, J. dhe G. -u qartësojnë që G. -u do të takohet me Z. përpara bankës “si zakonisht”. Në orën 12:24:03, G. -u i thotë J. ..”26 për të dhënë..” Kjo është interpretuar si G. -u të ketë paguar Z. €26,000 të tjera në shkëmbim për heroin. Më datën 12.09.2010, Z. i ka dërguar një mesazh SMS B.K. duke i thënë, “...i. 24900..” Sipas transaksionit të mëparshëm më datën 27.08.2010, ky është konfirmim nga Z. drejt J. se Z. i ka paguar J.24,900 euro (modus operandi i dërgesave dhe ndarja në vijim është përsëritur shumë herë)

Trafiku telefonik në mes të F.Z. dhe J. ka ndodhur më 14/09/2010. Në orën 19:05:01, J. pyet “.. ke marrë edhe 16 të tjera sot por nuk ke dërguar asgjë.” Z. u përgjigj se, “shqiptari më dha 11” dhe se, “ai tjetri 12”. Një mosmarrëveshje me J. ka iritur që Zeka nuk i kishte dërguar shuma më të mëdha që J. kishte pritur. (Nuk ka shpjegim tjetër që bisedat kanë qenë lidhur me narkotikë nga provat e tjera (Raportet e policisë, deklarata e TH. A. dhe narkotikët e marrë.))

Një bisedë e gjatë telefonike është bërë në mes të G. dhe J.më 22.09.2010 në orën 20:41:24 ku ata kanë diskutuar shumat që J. kishte pranuar deri në atë moment nga G.-u, ku kjo ishte €54,000 (“54”). Nuk ka shpjegim tjetër që ata kanë biseduar për paratë për narkotikë.

Në orën 17:20:55, G.-u ka kërkuar nga J. të organizojë një takim në mes të G. -ut dhe Z. për orën 18:30 të njëjtën mbrëmje. Pastaj, J. menjëherë ka telefonuar Z. (B.) në orën 17:22:32 dhe ka kërkuar nga ai të vijë “para bankës në orën 18:30”.

Në orën 19:37:21, J. i ka telefonuar G.-ut dhe G.-u ka deklaruar “.. është kryer” dhe se i kishte dhënë atij [Z.] “22”. Qartë, një shkëmbim tjetër i narkotikëve do të bëhej i lehtësuar nga J. ku G.-u do t’i paguante Z. shumën prej €22,000 për të kryer pjesën e tij.

Pataj, të hënën, më 11.10.2010 në orën 11:26:26, J. i ka thënë G.-ut të shkojë në shtëpi sa më shpejtë që është e mundur dhe “t’a presë atë në një vend atje.” Në orën 14:09:01, J. i ka telefonuar Gack-ut dhe e ka pyetur nëse G.ishte aty gjë që e konfirmoi G.dhe J. u përgjigj duke thënë, “.. ai do të jetë atje brenda 10 minutash.” J. prapë e thirri G. në orën 14:15:04 dhe e pyeti, “.. a mund t’i japësh diçka?”, ku G. pyeti, “sa duhet t’i japm?”, dhe J. u përgjigj, “rreth 4 apo 5”. Ata u pajtuan që G. t’i jepte 5 dhe G. u pajtua të thërrasë J. kur G.të ketë parë “atë.” Në fakt, kur G.u arrestua më vonë atë ditë dhe kur apartamenti i tij në XX, Essenbach ishte bastisur, ishin marrë €5,000 në para të gatshme. (shih Raportin e Policisë të Policisë gjermane).

Në orën 14:35:19, J., i inatosur, ka thirrur G. dhe i ka thënë te shkojë në shtëpi sepse “ai idioti ka shkuar në Ausburg te një adresë tjetër”. Në orën 15:34:50, J. i ka thënë G. “Do të tregoj se çfarë tipi të makinës ka ai ..me Mercedes tëkuq.”

Në orën 15:41, A, dhe B., korierët, janë arrestuar duke vozitur një Mercedes Benz C class të kuq me targa sllovene MS Z1-438 para pronës së G. dhe para se të bëhej dorëzimi. G.u arrestua në orën 15:44 para rezidencës. Në fakt, në telefonin mobil të marrë nga B. ka qenë një SMS i orës 14:40 dhe datës 11.10.2010 me një adresë në të “Essenbach, XXX” nga një numër mobile të serbisë dhe një mesazh tjetër SMS i orës 14:43 dhe datës 11.10.2010 nga një numër slloven që thoshte, “do të marrësh 5 mijë.” Në mes të orës 16:07 dhe 17:24 dhe pas arrestimit të G.-ut, J. ka thirrur numrin e G.-ut tetë herë duke panikuar se G. nuk e kishte kontaktuar për të konfirmuar shkëmbimin.

Pakot e heroines ishin marrë dhe analizuar si edhe ekzemplarët e tjerë që janë marrë nga shtëpia e G. Kur është bastisur makina, janë gjetur 9 pako me pluhur me peshë 4.56 kg të fshehura në kapakun e përparmë të rrotës që përmbanin 1.27 kg heroinë të pastër.

A. dhe B. ishin korierë. Ata ishin lidhja në mes të G.-ut dhe J., ata kanë pasur pozitën e njëjtë si F.Z..

Gjatë bastisjes së pronës së G.-ut, janë gjetur një numër i gjëseneve inkriminuese. Në veçanti, një numër i telefonëve mobil; një biletë aeroplani kthyesë nga Minheni në Prishtinë (1-15.12.2007); një numër i SIM kartelave të IPKO Kosovë; një kalendar (në një faqe, shkruar me dorë është fjala ‘V.’ mbi një numër telefoni fiks të Gjermanisë XXX – më vonë është gjetur të jetë linjë e regjistruar në emër të S. V. nga Gschmeidmachergasse , XX, e cila është nëna e Y. J.;

një pasaportë e lëshuar në emër të G.-ut me vulëhyrëse të Kosovës të datës 28.05.2010; dhe €5,000 në para të gatshme.

Shuma prej €5,000 e gjetur në pronë përputhet plotësisht me bisedën që G. ka pasur me J. në orën 14:15:04 atë ditë kur J. i kishte thënë G.-ut që t'i japë korierit "5."

Të gjitha bisedat kanë të bëjnë me dërgesa narkotikësh. Si rezultat i kësaj narkotikët e konfiskuar dhe telekomunikimet e mëparshme nuk japin shpjegim tjetër. Periudha kohore është përcaktuar nga koha e bisedës. Lidhja Kosovë – Gjermani është përcaktuar nga faktet në vijim: Y.J. dhe korierët (Z., A., B.) janë Kosovarë, lidhja në Gjermani (G.-u) ka pasur për qëllim shpërndarjen e heroinës në zonën e Munich (deklarata e TH. A.). Gjatë kontrollit të pronës së G. janë gjetur sende të cilat vertetojnë në mënyrë indirekte lidhjen e G. me Kosovën. Objekti i veprave penale – heroina -, pesha dhe cilësia e saj janë vertetuar nga raporti i ekspertit nga laboratorit i policisë në Gjermani. Provat mbështesin njëra tjetrën në mënyrë reciproke dhe krijojnë gjetjet e përshkuara në dispozitiv. Provat materiale – heroina e konfiskuar në apartamentin e B., stili i jetës i pasur i J.dhe deklarata e TH. A. sigurojnë çelësin e interpretimit të bisedave të përgjuara.

Blerjet me S.F., M.D. dhe F.Z., periudha mes 13 gushtit 2010 dhe 14 shtatorit 2010, Y.J. (lidhja F.)

Prova themelore janë 418 gramë heroinë e konfiskuar që është gjetur në apartamentin e M.D.. Lidhja mes heroinës së konfiskuar dhe Y. J.dhe heroinës është vertetuar nga bisedat e përgjuara mes mbajtësit të heroinës M.D. dhe S.F. dhe bisedës mes F. me Z. dhe J.. Edhe në këtë dërgesë Z. tregohet si korier. F.Z. është person kyç sepse ai ka qenë lidhja – korieri mes Gjermanisë (O. dhe G.-u) Kosovës (J.). (dëshmitari TH. A. gjithashtu ka konfirmuar në gjykatë pozitën e Z. se në apartamentin e F.Z. policia gjermane ka konfiskuar shumën e parave prej 64,400 Euros)

Me datë 13.08.2010, F. ka kontaktuar J. në orën 13:34:40 ku ata kanë diskutuar që F. të hyjë në kontakt me D. Më vonë F. ka kontaktuar përsëri J. në orën 14:46:22 ku kanë biseduar më tej. D. dhe F. i kanë thënë J.se ai do ti thonte asaj "të lëvizte bythën" Të nesërmen me datë 14.08.2010 në orën 11:57:22, J. ka kontaktuar Z. dhe e ka pyetur atë nëse ai "mund..të ishte aty në dy e gjysëm ...përpara bankës." Në orën 13:08:15 F. dhe J. diskutojë më tej një mbërritje të D. ku njëri prej tyre deklaroi "Thërrasim përsëri më vonë... pastaj mund të më thuash çfarë ka blerë." Në orën 14:25 me datë 14.08.2010, F. ka thirrur J. dhe J. i ka thënë atij se ishin "14". Kjo ka të bëjë me paratë që D. kishte paguar, nënkuptohet qartë se ajo ka paguar €14,000 Z. për heroinën. Provë tjetër lidhur me kryerjen e këtij transaksioni është se me datë 16.08.2010 në orën 02:25:09, Z. ka dërguar një sms një kontakti në Kosovë "i. 13300." Në përputhje me praktikën e tyre, Z. kishte zbritur pjesën e tij nga 14,000 për këtë transaksion të drogës, pjesa tjetër ishte për Y. J..

Me datë 23.08.2010, F. ka bërë Z. pagesën prej €9,900 , para këto që kishin ardhur nga D.. Kjo është ndërtuar në mënyrë që me datë 17.08.2010 në orën 18:01:16, F. ka kontaktuar J. duke treguar se "ajo [D.] do të vijë tek unë pasnesër."

Në orën 22:15:21, F. ka thirrur D. dhe i ka thënë asaj se ai ishte tek dera e saj. Në orën 22:29:04, J. ka thirrur F. dhe ata kanë biseduar rreth mundësisë së F. për tu takuar në orën 12 por J. ka thënë se ai duhej të verifikonte nëse kjo ishte kohë e përshtatshme. Në orën 22:31:22, J. ka pyetur nëse Z. mund të ishte përballë bankës në orën “12”. Menjëherë pas, në orën 22:55:41, F. ka telefonuar J. dhe i ka thënë “10”. Me datë 24.08.2010, Z. ka dërguar një sms në numrin e Kosovës 00386 49317886 lidhur me një pagesë “Liberia 9600.” Kjo është padyshim pagesa prej €10,000 bërë Z. nga F. për heroinë për D. minus pjesën e Z. dhe që i paguhet J.

Biseda e datës 13.8-20.8.2010 kishte të bënte me një pagesë tjetër për narkotikë të konfiskuar në apartamentin e M.D. (shuma dhe peshë të ndryshme) por nuk ka dyshim se biseda (e njëjta modus operandi) kishte të bëjë me narkotikë; pavarësisht mungesës së provave të tjera vertetuese (nuk janë konfiskuar narkotikë). Kjo bisedë ilustron marrëdhënien mes pjesëtarëve të tjerë të grupit.

Me datë 13.09.2010, ka pasur kontakt mes F. dhe D. ku është caktuar një takim mes orës 17:30 dhe 18:00. F. ka kontaktuar një taksist dhe është transportuar tek prona e D. në XX, XX, Munich. Në orën 21:25:24, F. ka kontaktuar J. nga një kabinë telefoni për të caktuar një takim mes F. dhe Z. gjatë së cilit F. pyet J. “a mund ta thërrasësh atë?” dhe pastaj thotë se takimi duhet të jetë në njëmbëdhjetë pa pesëmbëdhjetë. Menjëherë pas kësaj, J. kontakton Z. dhe i kërkon atij të jetë tek banka në orën 22:45 (kjo është XX në XX në Munich). Në orën 22:59:37, F. ka thirrur J. nga një kabinë telefoni duke pyetur ku është Z. Megjithatë, gjatë bisedës, F. deklaron “prit, besoj se po vjen, prit, erdhi.” Pastaj F. dëgjohet duke biseduar me një person të tretë dhe duke thënë se është në rregull.

Me datë 14.09.2010 në orën 09:57:41, Z. ka dërguar një SMS në Kosovë lidhur me pagesën hyrëse duke shkruar “I. 11500”. Është vertetuar se shumica ka kaluar nga D. tek F. dhe pastaj është paguar Z. €12,000 që do të përputhej me rreth 750 gr heroinë.

Provë tjetër për furnizimin për D. është se me datë 14.09.2010, pas arrestimit të D., është kontrolluar apartamenti i D. dhe janë konfiskuar rreth 418 gr heroinë.

Është vertetuar se të gjitha bisedat kanë të bëjnë me dërgesa narkotikësh. Kjo është vertetuar në mënyrë të mjaftueshme nga narkotikët e konfiskuar dhe bisedat e mëparshme për të cilën nuk ka ndonjë shpjegim tjetër. Periudha kohore përcaktohet nga koha e bisedës. Lidhja Kosovë – Gjermani është vertetuar nga faktet në vijim: Y.J. dhe korieri (Z.) janë Kosovarë, lidhja në Gjermani F. ka pasur për qëllim të shpërndajë heroinën në zonën e Munich (deklarata e TH. A. në shqyrtim kryesor e datës 10 shtator 2013). Objekti i veprave penale – heroina -, pesha dhe cilësia e saj janë vertetuar nga një raport i ekspertit lëshuar nga laboratorit e policisë në Gjermani. Provat mbështesin njëra tjetrën në mënyrë reciproke dhe çojnë në gjetjet e përshkruara në dispozitiv. Provat materiale – heroina e konfiskuar në apartamentin e D., stili i jetës shumë i pasur i J. dhe deklarata e TH. A. sigurojnë çelësin e interpretimit të bisedave të përgjuara.

Destinacioni i narkotikëve M.O. Periudha mes datës 2 janar 2011 dhe 12 janar 2011 (A.M. korier)

Heroina e konfiskuar me peshë 1.992 Kg ka përbërë shtyllën e provave. Konfiskimi është çelës për interpretimin e bisedës mes pjesëmarrësve dhe nuk ka dyshime se telekomunikimet kanë pasur të bëjnë me narkotikë, çmimin e narkotikëve dhe çeshtje organizimi lidhur me dërgesat. Dëshmitari TH. A. pohon këtë dhe deklarata e tij mbështetet nga raportet e policisë Gjermane.

Me datë 03.12.2010 në orën 13:27:33, është zhvilluar një bisedë mes tyre ku ata kanë diskutuar një furnizim të ri, O. ka thënë se “ata mund të bënin të njëjtën si herën e fundit” dhe se, kur është pyetur nga J. kur mund të ishte gati, O. deklaron “rreth 3-4 javë, maksimum.” “të njëjtën si herën e fundit” do të thoshte marrëveshja për drogë e bërë me datë 31.08.2010 për 3 kg heroinë me çmim prej €55,000.

Kontakti mes O. dhe J. ka vazhduar gjatë dhjetorit të vitit 2010 dhe fillimit të janarit 2011 kur ata bisedojnë për të bërë diçka në mes të janarit dhe se O. është gati. Me datë 02.01.2011, në orën 20:44:56, O. dërgon një sms J. ku deklaron “Jam gati nga fundi i javës, e shtunë. A mund të bëjmë 3 për 54?” Me datë 06.01.2011 në orën 18:31:05, O. dërgon një sms tjetër ku thotë “të lutem më dërgo një mesazh kur të dish pak a shumë se çfarë do të ndërmarrim.”

Me datë 10.01.2011 në orën 18:25:20, J. dërgon sms ku pyet “a ke kohë nesër?” të cilit O. i përgjigjet në orën 18:27:08. “po, pasdite. A mund ta marr si banka e tij Raiffeisenbank?” të cilit J. i përgjigjet në orën 18:29:15 se ajo [marrëveshja] do të jetë “me dikë tjetër.” Dorëzimi do të bëhet në XX, XX, Munich. Ky personi tjetër ishte M. Me datë 10.01.2011, J. dërgon O.-it një SMS në orën 18:37:07 ku thotë se O. do të merrte 2 kg me çmim €37,000 (“janë 2.37”).

Me datë 11.01.2011, me anë të një sms të shkurtë në orën 08:46:14, J. i thotë O.-it se ora e dorëzimit do të jetë 14:00. Përmes disa mesazheve SMS, J. i jep O. -it udhëzimet si “më trego çfarë ke veshur dhe si do të të njohë ai ty” (12:22:04), dhe, në orën 12:28:41, se ai nuk duhet të harrojë telefonin e tij mobil. Në orën 12:49:35, O. përgjigjet se ai “kishte veshur rroba punëtori dhe çizme gome” dhe se do të përpiqej të ishte aty brenda dy orësh. J. udhëzon O.-in ti dërgojë atij, J., një SMS kur të jetë aty.

Në orën 14:29:27 J. dërgon O. -it një SMS ku thotë “më dërgo një SMS kur të arrish aty” të cilit, në orën 14:34:31, O. përgjigjet J. “Këtu jam” (kishte arritur në pikën e takimit). Në orën 14:53:37, J. ka thirrur O. -in për ti dhënë atij një përshkrim të rrobave që një person me emrin A.M., korier droge, kishte veshur (xhinse dhe xhakëtë të zezë).

Rreth orës 15:00, është bërë takimi mes O. dhe M. ku të dy janë vendosur në ulësen e pasme të veturës së O.-it dhe O.-i ka pranuar 2 kg heroinë në shkëmbim të €37,000. Kjo përputhet me saktësi me mesazhin sms të dërguar në orën 18:37 (“janë 2.37”). Gjatë shkëmbimit, të dy, O. dhe M. ishin në kontakt me telefon me J. Në orën 15:02:13, J. ka thirrur O.-in për të pyetur nëse gjithçka ishte në rregull ku O. përgjigjet, “po është mirë. Po ndahemi tani.” Ai poashtu e pyet

O.-in “a i dhe letrat atij?”. O. konfirmon këtë dhe përgjigjet “po...37...” Pastaj J. kërkon M. dhe M. pyet J.: “pra, do ti jap gjithë këtë këtij, kështu?” J. përgjigjet kësaj “po, vetëm jepja atij. Kur të ndahesh prej tij bjeri një herë telefonit tim.” Në orën 15:15, ata janë arrestuar të dy në pompën e benzinës Esso Tankstelle në XX në Munich. Pas ulëses së shoferit është gjetur 1.992 kg heroinë që M. i kishte dhënë O.-it. Arrestimi është përshkruar në raportin hetimor të policisë numër 0426 i datës 11.01.2011. Ajo gjendej në katër pako, me përbërje 8.3% dhe 8.4% heroinë dhe përmbajtja totale e heroinës ishte 155.18 gram.

M. është arrestuar në orën 19:00. Paratë që si kishte lënë në kafeteri janë marrur pastaj nga Z. mes orës 17:06 dhe 17:18 i cili pastaj i ka dërguar në apartamentin e tij në XX Strasse.

Apartamenti i M. në XX, XX është kontrolluar të njëjtën ditë dhe janë konfiskuar edhe 323.35 gr heroninë (21.45 gram heroninë e pastër) si dhe dy armë zjarri plotësisht funksionale të pambushuara (dy pistoleta: një Walther P99 dhe një Browning GDPA 9), municione dhe €4,230 .

Policia ka kontrolluar edhe apartamentin e Z. ku kanë gjetur €64,465 . Ka shumë gjasa që shuma prej €37,000 që i është Z. nga M. gjendej në atë shumë të përgjithshme.

Ajo që ka ndodhur pastaj është vertetuar përmes burimeve të ndryshme të provave: vëzhgime të policisë, përgjime dhe deklarata e TH. A.

Konfiskimi i parave dhe heroinës në apartamentin e M. dhe paratë në apartamentin e F.Z. mbështeten nga raportet e policisë Gjermane dhe verdikti kundër S.F. dhe M.O.i nxjerrur nga Gjykata Rajonale në Munchen I. Krahasimi i zërit dhe deklarata e TH. A. kanë zbuluar rolin organizativ të të pandehurit në blerjen e 1.992 kg heroinë.

Narkotikë te sekuestruar më 2 tetor 2012 në Kosovë

Më 2 tetor 2012, Y.J. në territorin e Kosovës, në rrugën XX, Prishtinë, zotëronte një përzierje të heroinës dhe paracetamol me peshe 11.66 gram të futura në një qese plastike dhe ajo u kap nga Policia nga pas tualetit në banjon e banesës së Y.J., Kosovë më 2 tetor 2012.

Më 2 tetor 2012, Y.J. në territorin e Kosovës, në katin e parë të shtëpisë së okupuar nga Y.J. në XX, Prishtinë, ku zotëronte 3.38 gram kanabis sativa dhe këto narkotikë janë kapur nga Policia.

Ekzaminimi mjeko-ligjor kimik ka konfirmuar se sendet e gjetura në lokal të pandehurit, materiali nga një shkurre e gjelbër ishte 3.38 gram mariuanë, dhe sendi i dytë i sekuestruar kishte një peshë neto prej 11.66 gram dhe përmbante heroinë të përzier me substanca të tjera. Heroina është karakterizuar në tabelën një, dhe ajo ishte e përzier me Acetaminophen përzier me kafeinë. Gjykata vendosi për konfiskimin e 3.38 gram mariuanë, dhe përzierjes 11.66 gram heroinë dhe paracetamol, sepse materialet e tilla janë objekt për kryerjen e veprës penale.

Ky akt është provuar nga deklaratat e dëshmitarit TH.L. dhe dëshmitarit A.S. Të dyja këto deklarata do të mbështeten me raportet policore. Gjykata beson se ky material (heroine, mariuana) nuk është i poseduar për përdorim privat. Aktet e mëparshme të tij provojnë sa duhet se i pandehuri, Y.J., nuk ishte vetëm përdorues, por edhe një tregtar. Peshorja elektronike e gjetur në banesën e të pandehurit në rrugën XX dëshmon se ai peshonte narkotikë. I vetmi person që peshon narkotikë është dikush që dëshiron për të shitur ato më vonë. Qëllimi për të shitur këto narkotikë edhe në një sasi të tillë të ulët u provua edhe nga dërgesat e tjera të organizuara dhe të koordinuara nga të pandehurit, Y.J., në Gjermani.

V. Konstatimet ligjore

Gjykata ka konstatuar se i pandehuri ka kryer njëkohësisht dy vepra penale nga një veprim në vazhdim, (vepra në harmoni). Edhe pse aktakuza përmban pesë (5) aktet e veprës penale të paautorizuar, blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope në kundërshtim me nenin 229, par. 1, 2, 3, gjykata mendon se veprimet e të pandehurit kishte karakter të vazhdueshëm. Objekti i veprës ishte i njëjti - narkotikë dhe droge, sidomos qëllimi për të shitur. I pandehuri kishte të njëjtin synim si kryes për t'u marrë me narkotikë me qëllim për të fituar nga blerja e tyre në vijim. Gjykata percaktoi gjithashtu se veprimet janë kryer në të njëjtat kushte.

Gjykata mendon se të gjitha elementet e kualifikimit ligjor të veprës penale blerjes, posedimit, transportit dhe shitjes të paautorizuar, të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope në kundërshtim me nenin 229, par. 1, 2, 3 në bazë të Kodit Penal të Kosovës, (e vlefshme deri 31.12.2012) janë përmbushur njëjtë si në bazë të Kodit Penal të Kosovës (i vlefshëm nga 01.01.2013) ku përkufizimi ligjor i veprës penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe analoge është parashikuar nga neni 273 paragrafi 1, 2, 3.

I pandehuri Y.J. nuk ka pasur autorizim për blerjen, posedimin, shpërndarjen, transportimin, eksportimin ose importimin e narkotikëve të rrezikshëm. Heroina e konfiskuar në Gjermani dhe, gjithashtu në banesën e tij që ai okuponte në Kosovë, janë narkotikë të rrezikshme, po ashtu si kanabis (LIGJI NR. 02/L-128 PËR BARNAT NARKOTIKE, SUBSTANCAT PSIKOTROPE DHE PREKURSORËT).

Praktikisht i pandehuri J. ka koordinuar transportin dhe shpërndarjen e eksportit/ importit të narkotikëve. Angazhimi i tij mund të konsiderohet edhe si bashkëpunim në vepra penale, por në këtë rast bashkëpunimi në vepra penale është konsumuar me veprën penale të krimit të organizuar.

Neni 274 paragrafi 7, nënparagrafi 2 dhe 4 i Kodit Penal të Kosovës përcakton grup të organizuar kriminal, si një grup të strukturuar ekzistues për një periudhë kohore dhe që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda në mënyrë që të

marrë drejtpërdrejt ose indirekt, një përfitim financiar ose material. Grupi i strukturuar do të thotë grup prej tre ose më shumë personave që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale dhe nuk duhet të ketë përcaktuar zyrtarisht rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose të organizimit të zhvilluar.

Në bazë të nenit 274 paragrafi 7 nën-paragrafët 3 të Kodit Penal (kodi i vjetër) krim i rëndë do të thotë një vepër penale e dënueshme me burgim prej së paku katër vjet. (Të njëjtat kufizime janë të kërkuara nga Kodi i Ri Penal (shih nenin 283 paragrafi 1 nga Kodi i ri Penal).

Ligjvënësi e ka futur veprën penale të krimit të organizuar për të mbrojtur shoqërinë nga forma shumë të rrezikshme të akteve të paligjshme definuar si krim i organizuar. Pasojat e veprës penale, blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope konsiderohen si jashtëzakonisht të rrezikshme për shëndetin e njeriut që është arsyeja pse qëllimi i kësaj vepre penale është parandalimi dhe mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe jetës nga substancat e rrezikshme.

Dispozitivi përmban gjetjet faktike të cilat janë konstatuar të vërtetuara jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

Një nga elementët e veprës penale të krimit të organizuar është kryerja e krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar. Gjykata ka përshkruar në dispozitiv krimet e rënda që ishin elementë të veprës penale të krimit të organizuar. Disa nga blerjet / dërgesat veprat -penale të cilat janë në akuze si element i krimit të organizuar dhe të cilat i atribuohet grupi i organizuar janë lënë jashtë dispozitivit të këtij aktgjykimi për shkak se ata nuk ishin të akuzuar gjithashtu për vepër penale blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes të paautorizuar, të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike. Krimi i organizuar nuk mund të kryhet pa kryerjen e një krimi të rëndë siç është vendosur nga instancat më të larta gjyqësore. Gjykata do të zgjerojë aktakuzën e aktivitetëve kriminale të të pandehurit në baze të kontradiktës së akteve të ngarkuara.

Ligjet e perdorura

Veprat penale të përmendura më lart janë kryer para 1 janar 2013. Kodi i ri penal është i vlefshëm nga 1 janari 2013. Aktet e përshkruara mësipërme konsiderohen si vepra penale para 1 janar dhe edhe pas 1 janar 2013. Gjykata ka përdorur ligjin material më të favorshëm për të akuzuarin.

Kodi i vjetër Penal e cilëson aktin e lartpërmendur si veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar, të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope në kundërshtim me nenin 229, par. 1, 2, neni 3 pajtim 229 paragrafi 3 dhe kjo mund të dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dhjetë vjet. Kodi i ri Penal kualifikon atë si vepren penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar, të narkotikeve të rrezikshëm, substancave psikotrope dhe analoge, sipas nenit 273 paragrafi 1, 2, 3 dhe sipas nenit 273 paragrafi 2 kjo mund

të dënohet me gjobë dhe burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se ligji më i favorshëm në bazë të këtij krahasimi është Kodi i Vjetër Penal.

Kodi i vjetër penal e cilëson aktin e lartpërmendur si krim të organizuar në pajtim me nenin 274 paragrafi 3 dhe ky mund të dënohet me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet dhe me gjobë deri në 500.000 euro. Kodi i ri penal e cilëson aktin e lartpërmendur si pjesëmarrja apo organizimi i një grupi të organizuar kriminal, sipas nenit 283 paragrafi 2 dhe kjo mund të dënohet me një gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim nga dhjetë gjer në njëzet e pesë vjet. Prandaj, ligji më i favorshëm në këtë rast është Kodi i vjetër Penal.

VI. Denimi

Gjykata ka shqiptuar dënimin prej tre deri në dhjetë vjet të parapare për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, sipas nenit 229 par. 3 CCK (e vlefshme deri më 31/12/2012). Gjykata është shumë mirë e vetëdijshme për rrethanat lehtësuese dhe rënduese të të pandehurit. I pandehuri nuk ka shprehur ndonjë keqardhje dhe nuk kishte bashkëpunuar me autoritetet gjyqësore. Prokurori deklaroi se i pandehuri u dënua në Gjermani për aktivitete të ngjashme penale të lidhura me narkotikët. Ky fakt nuk është konsideruar si një rrethanë e rëndë e as të pandehurit nuk konsiderohen si përsëritës për shkak se dënimi i tillë nuk ka qenë i njohur në Republikën e Kosovës. Gjykata ka shqiptuar dënimin në mes të kufijve duke pasur parasysh që rrethanat lehtësuese janë të humbura. Gjykata nuk e konsideron pohimin e tij se ai ishte i varur nga heroina si rrethanë lehtësuese. Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me dënimin për vepra që kanë të bëjnë me vepra te natyres narkotike drejtohet nga sasia e konsiderueshme materiale e veprës se subjekti i veprës është përafërsisht 7 kg heroinë (jo në cilësinë më të lartë) dhe përafërsisht. 3 g kanabis sativa (me cilësi të panjohur). Legjislacioni nuk përputhet saktësisht me sasinë e narkotikëve apo efektivitetit të narkotikëve të tilla të rrezikshme me peshën e veprës së kryer penale të rrezikshme. Megjithatë, Gjykata nuk mund të injorojë një sasi të tillë të blerë / poseduar / transportuar / e importuar e substancave narkotike të rrezikshme e cila ul / rrit peshën e veprës penale të shoqërisë. Ndikimi ndërkombëtar i rrethanave rënduese te veprës narkotike te lidhura me rrethanat renduese te parashikuara nga ligjvënësi sipas nenit 229, paragrafi 3 i KPK-së.

I pandehuri Y.J. u dënua edhe për veprën penale të krimit të organizuar. Ai e ka kryer këtë veprë penale me veprimet e njëjta si veprën penale, blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike. Graviteti i kryerjes së kësaj vepre është percaktuar nga roli i tij në grupin e organizuar kriminal. I pandehuri Y.J. nuk ishte një "kalorës" i thjeshtë apo një "ushtar" megjithatë pozita e tij në grup të organizuar kriminal nuk mund edhe të mbivlerësohet. I pandehuri ka përdorur lidhjet e tij në Gjermani, por ishte ai që dërgoi korrierët në Gjermani me narkotikët e rrezikshëm / heroinën. Ishte ai i cili bashkërendoi dorëzimin e narkotikëve, por ishte ai që mblodhi përfitimin material, pas zbritjes së

aksioneve për korrierët. Roli i tij i rëndësishëm në grupin e organizuar kriminal është i dukshëm nga aksionet e dhëna atij. Gjykata është e vetëdijshme se heroina e tillë nuk ishte prodhuar nga të akuzuarit (supozohet se heroina e tillë është importuar nga vendet e huaja ndoshta Turqi, Afganistan), kështu që logjikisht kjo do të thotë se ai kishte për t'i derguar një pjesë të aksioneve të tij dikujt tjetër gjithashtu. Ai operonte me partnerët e pavarur gjerman (O., G., M. etj). Aksionet e Y.J. në aktivitete kriminale të grupit ishin më të larta se të autorëve të tjerë, angazhimet e të cilëve janë vërtetuar nga gjykata Gjermane. Nëse e shqipton dënimin për veprë penale të krimit të Organizuar, Gjykata mban parasysh se pozita e tij në grupin e krimit të organizuar ishte si koordinator, ai ishte një njeri që ishte në krye të pjesës ekzekutive e grupit.

Gama (kufijte) e dënimin për veprën penale të Krimit të Organizuar është shtatë deri në njëzet vjet. Gjatë shqiptimit të 8 tetë vjet dënim me burg, Gjykata mori parasysh faktin se rëndësia negative të akteve të tilla reflektohet në paragrafin 3 të nenit 274, dhe e tërë gama 7-20 vjet duhet të mbulojë veprime më të rënda se sa ato të gjetura në këtë gjykim.

Motivi i spekulimit është reflektuar duke vendos një gjobë në shumën 25,000 EURO. Në pajtim me Nenin 39 paragrafi 1 i KPK-së dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se 50 EURO. Dënimi me gjobë nuk mund të kalojë 25.000 euro ose, në rastin e veprave penale të kryera për të marrë një përfitim material, kjo nuk mund të kalojë 500.000 euro.

Edhe pse stili i jetës i të pandehurit ishte shumë i pasur siç u provua nga bastisja e shtëpisë dhe rrjedhja e parasë në llogaritë e tij megjithatë, nuk është vërtetuar se një mënyrë jetese e tillë e pasur është financuar tërësisht nga aktivitetet kriminale. Shuma e tillë e gjobës gjithashtu pasqyron situatën ekonomike të një kosovari të zakonshëm familja e të cilit jeton dhe punon jashtë vendit, në këtë rast familja e të pandehurit jetojnë dhe punojnë në Gjermani dhe një dënim i tillë nuk le menjane shenjat e ndarjes sic është e parapare me ligj.

Llogaritja e dënimin për vepra të njekohshme behet sipas nenit 71 paragrafi 2 i KPK-së. Gjykata pret nga njëmbëdhjetë vite të dënimin me burgim izolimin e dhunuesit, i cili për gati dy vjet ka vazhduar aktivitetet e tij kriminale duke ditur efektin e varur dhe helmimin e shkaktuar nga narkotikët në trupin e tij. Efektet e heroinës për trupin e njeriut dhe personalitetin janë të njohura në përgjithësi, pra shpërndarja e këtyre narkotikëve do të thotë se kryesi ka shpërndarë qëllimisht narkotikë, dhe duke bërë këtë ka shkaktuar probleme serioze shëndetësore sociale dhe ekonomike. Nevoja e shoqërisë është për të mbrojtur njerëzit më së shumti të rinj jeta e të cilëve mund të jetë shkatërruar nga narkotikët. Mënyra, karakteri përsërites i veprimeve të të pandehurit dhe këmbëngulja e tij në kryerjen e këtyre veprave penale kerkojnë për një izolim të kohe të gjatë nga shoqëria. Gjykata arrin në përfundimin se motivet e veprimeve të tilla të rrezikshme për shoqërinë ishin tërësisht spekulim.

VII. Konfiskimi

Konfiskimi i 11.66 gram përzierje e heroinës dhe paracetamolit dhe 3.38 gram kanabis sativa të sekuestruara më 2 tetor 2012 është vendosur në pajtim me nenin 54, paragrafët 1, 2,

nënparagrafin 7, nenin 60 dhe nenin 229, paragrafi 5 i Kodit Penal e Kosovës (e vlefshme deri më 31 dhjetor 2012).

VIII. Shpenzimet e gjykates

I pandehuri është i detyruar të paguajë shpenzimet e procedurës penale si më poshtë: Shuma 2.500 EUR për Ekspertizen e Zerit, shuma prej 449 euro për panelin e ekspertëve dhe shuma e bere nje herësh prej 1.000 euro, në bazë të nenit 365 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të KPPK-së. Të gjitha shpenzimet e mësipërme rezultuan nga strategjia e tij e mbrojtjes Neni 453, par. 1 të KPPK-së parashikon që i pandehuri duhet të rimbursojë shpenzimet e procedurës penale, kur Gjykata e gjen atë fajtor.

Në lidhje me vazhdimin e paraburgimit, nxirret një vendim i veçantë në të cilin janë dhënë arsyet e hollësishme. Hartuar në anglisht, një gjuhë e autorizuar. Arsyetimi i Aktgjykimit është finalizuar më 4 shkurt 2014³⁸.

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, në bazë të nenit 380 paragrafi 1 të KPP-se.

Vladimir Mikula

Vlora Johnston

Kryetar i Trupit Gjykes

Procesmbajtese

³⁸ Afati kohor per perpilimin e aktgjykimit eshte zgjatur nga Kryetari i Gjykates Themelore te Prishtines me 18.12.2013 sipas kerkeses se kryetarit te trupit gjykes.